**UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU, DURRËS**
**FAKULTETI I BIZNESIT**
**DEPARTAMENTI FINANCË - KONTABILITET**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave "FINANCË - KONTABILITET"**

**Institucionit të Arsimit të Lartë "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Armela ANAMALI *(Koordinatori i programit të studimit)*
2. Dr. Bitila SHOSHA *(Lektore e Departamentit Financë-Kontabilitet)*
3. Prof.Asc. Shqipe XHAFERRI *(Lektore e Departamentit Financë- Kontabilitet)*
4. Artan ALIAJ *(Përfaqësues Biznesi)*
5. Elena BOJA *(Studente , MSc Financë-Kontabilitet)*
6. Spiro PACO *(Koordinatori Institucional i IAL pranë ASCAL)*
7. Marsida DYRMISHI *(Specialist DKSC)*

Mars/2023

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i studimit **'Master i Shkencave në Financë -Kontabilitet'** i ofruar nga Universiteti "Aleksandër Mosiu", Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Financë - Kontabilitetit është hapur në vitin akademik 2018 - 2019 me Urdhër të MASR. Nr.654, Datë 11.10.2018. Emërtimi i programit të studimit **'Master i Shkencave në Financë -Kontabilitet'** është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit; Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit, etj.

Me një kurrikul bashkëkohore dhe një staf të kualifikuar, ky program bën të mundur që studentët të ndihen të sigurtë të vazhdojnë rrugën e tyre drejt studimeve të mëtejshme apo karrierës profesionale brenda dhe jashtë vendit.

Misioni i këtij programi është edukimi i thelluar, nxitja e kërkimit të avancuar, përmirësimi i aftësive praktike në fushat e financës dhe kontabilitetit. Ky program është projektuar, që studentët:

- Të aftësohen për punë kërkimore dhe zhvilluese në dobi të firmave, industrive, institucioneve publike dhe të instituteve kërkimore shkencore për gjetje dhe zhvillim përvojash si Brenda vendit, rajonit dhe në rang më global.
- Të krijojnë shtesë vlerash për gjatë karrierës së tyre në përgjigje të oportuniteteve të ndryshme që mund të hasin.
- Të përgatiten profesionistë në fushën e kontabilitetit, në mënyrë të tillë që të zhvillojnë aftësitë e nevojshme analitike për të zgjidhur problemet që lidhen me fushën e kontabilitetit dhe finances.
- Të ofrojë njohuritë e nevojshme në standadet e raportimit financiar, etikës së biznesit dhe përgjejgësisë së drejtuesve financiarë.
- Të aftësohen për të përkthyer në vendime të duhura informacionin e përmbajtur në pasqyrat financiare sipas standarteve ndërkombëtare në përgjigje sa më efikase të rrethanave në marrëdhënie biznesi kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të realizojnë teknika sa më të përparuara për identifikimin vlerësimin dhe kontrollin e rrezikut.
- Si drejtime të tjera plotësuese në formimin profesional dhe shkencor të studentëve përfshijnë njohjen e strukturave të tregjeve financiare, të palëve që përfshihen në to, të instrumentave financiarë që tregtohen si edhe të ndikimit të transaksioneve të ndryshme që zhvillohen në këto tregje. Kjo përfshin edhe aplikimin e derivativave financiare si alternativa më të avancuara të amvisimit të rrezikut.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* i ngritur nga Titullari i Njësisë Kryesore me *Vendim nr.7, datë. 07/02/2023* (i ndryshuar) udhëhiqet nga parimet e mëposhtme të punës:

- Profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tabllo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për proçesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, proçedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

*Përshkrimi i Grupit të vlerësimit të brendshëm*

-Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Këshilli i Akreditimit.

-Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL.

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, i cili ngrihet nga titullari i njësisë, *Vendim Nr.7, datë. 07/02/2023* .

-Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.

-Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas manualit të ASCAL. Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë dhe ASCAL.

-Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas kërkesave e udhëzimeve në manualin e ASCAL dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e njësisë, dekanatin dhe strukturat përkatëse brenda IAL-së.

-Dorëzimi në ASCAL i RVB në afatet e përcaktuara.

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) përbëhet nga *6 fusha kryesore*. Çdo fushë ka standartet dhe kriteret përkatëse që kërkohet të vlerësohen. Grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) ka vlerësuar çdo fushë në tërësi dhe çdo standart e kriter në veçanti. Vlerësimi është bërë duke u mbështetur në aktivitetin e programit Master i Shkencave "Financë – Kontabilitet" që më hapjen e këtij programi në vitin akademik 2018-2019. Çdo kriter është vlerësuar duke u mbështetur në dokumenta justifikuese më poshtë të emërtuara si evidenca. Raporti Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit Master i Shkencave "Financë – Kontabilitet" përmban vlerësimin për këto fusha:

I. Ofrimi i Programeve të Studimit
II. Organizimi, Drejtimi dhe Administrimi i Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë
III. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat
IV. Burimet Njerëzore, Financiare, Infrastruktura, Logjistika për Realizimin e Programit të Studimit
V. Studentët dhe mbështetja e tyre
VI. Sigurimi i Cilësisë së Programeve të Studimit

# I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Strategjinë për Arsimin e Lartë dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore në fuqi[1 2 3 4 5].<br>Në ditët e sotme UAMD-ja dhe njësitë përbërëse të tij, si Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti Financë-Kontabilitet kanë fituar një rol të rëndësishëm në shoqëri, si një aktor vital për zhvillimin social dhe ekonomik në nivel lokal dhe kombëtar.. UAMD-ja është një kolonë e rëndësishme institucionale: për formimin e kapaciteteve të reja; në respektimin e të drejtave të njeriut; përqafimin e plotë të strategjive për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit; promovimin e demokracisë dhe paqes në vend dhe më gjërë. *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* krahas vlerave akademike që mbart, përcjell dhe një frymë të konsoliduar të zhvillimit dhe mbrotjes së interesit dhe vlerave kombëtare[6 7 8 9]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është në përputhje me misionin dhe qëllimet që UAMD e njësitë përbërëse të tij, kanë në ofrimin e një edukimi akademik dhe profesional sipas standardeve më të larta akademike bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombetare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë [10 11].<br>*Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është dizenjuar të përgatit studentët për një karrierë të suksesshme, nën reflektimin dhe plotësimin e nevojave që ka mjedisi akademik dhe profesional për njohuri të integruara dhe gjithëpërfshirëse në fushat përkatëse. Thelbi i programit fokusohet në formimin e të menduarit kritik tek studentët, me aftësinë për të menduar dhe vepruar njëkohësisht si dhe për të gjykuar situatat specifike më të cilat po përballen organizatat, tregjet financiare dhe jofinanciare si dhe ekonomitë e vendeve[12 13 14]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike te Institucionit. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është shembulli më i mirë sesi UAMD-ja dhe njësitë përbërëse të tij (Fak.Biznesit dhe Departamenti Financë-Kontabilitet) ka arritur të përmbushë një objektiv të rëndësishëm të Planit Strategjik të Zhvillimit 2016 – 2020, ofrimin e një programi që jo vetëm plotëson nevojat e tregut, por nxit të rinjtë të përparojnë në kërkimin shkencor përmes studimeve të thelluara në këtë fushë[15 16]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet | **Po.** Hapja, zhvillimi dhe riorganizimi i *Programit Master i Shkencave "Financë-* |

[1] Evidenca 1: Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[2] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[3] Evidenca 3: Strategjia Kombëtare për Teknologjinë, Shkencën dhe Inovacionin 2017-2021
[4] Evidenca 4: Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive në Shqipëri (2021 - 2024)
[5] Evidenca 128: Urdhër Nr.654, Dt. 11.10.2018 MASR_Hapja e Programit MSH Financë-Kontabilitet
[6] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[7] Evidenca 5: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[8] Evidenca 8: Kërkesë për hapjen e programit MSc Financë-Kontabilitet
[9] Evidenca 7: Kodi i Etikës, UAMD
[10] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[11] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[12] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[13] Evidenca 9: Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit
[14] Evidenca 10: Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet
[15] Evidenca 5: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[16] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025

| | |
|---|---|
| e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit rnbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | *Kontabilitet"* është realizuar në përputhje dhe i udhëhequr nga Plani Stretegjik i Zhvillimit të UAMD në nivel institucioni dhe njësive përbërëse të tij. Ky plan strategjik, ashtu siç shprehet është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit, pasi reflekton në mënyrë të vazhdueshme përmirësime në planet mësimore, programet e lëndëve, duke reflektuar ndryshimet në strategjinë kombëtare të zhvillimit, kombinuar edhe me trendet ndërkombëtare. Pra organizimi dhe përmbajtja e *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* vjen si pjesë integrale e një vijueshmerie të planeve strategjike të cilat fillojnë më Strategjinë e Zhvillimit dhe Integrimit [17], Strategjinë Kombëtare për Shkencën dhe Teknologjinë[18], Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive në Shqipëri (2021 - 2024)[19] , Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD 2016-2020[20] dhe 2020-2025 [21] dhe njësive ofruese të këtij programi[22 23]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.2<br>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegëse për programin e studimit në institucion | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojen, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushen akademike specifike për ofrimin e në programi studimi në atë fushë. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ofrohet nga Departamenti Financë-Kontabilitet, pranë Fakultetit të Biznesit që prej vitit akademik 2018-2019. Njësia përgjegjëse ofruese e këtij programi plotëson të gjitha kërkesat ligjore[24] dhe zotëron të gjithë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për zhvillimin e tij. Stafi i angazhuar në realizimin e këtij programi gëzon një përvojë akademike dhe profesionale, e cila është shfrytëzuar më së miri në realizimin e këtij programi[25 26]. Departamenti ku bën pjësë dhe programi në fjalë kanë njohur rritje të qëndrueshme gjë që dëshmon për interesin i cili buron edhe nga cilësia e ekspertiza e shërbimit të ofruar [27 28 29]. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit | **Po.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë krysore, Fakultetit të Biznesit dhe njësisë bazë, Departamenti Financë-Kontabilitet përgjegjës për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane [30 31 32 33]. |

[17] Evidenca 11: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020
[18] Evidenca 3: Strategjia Kombëtare për Teknologjinë, Shkencën dhe Inovacionin 2017-2021
[19] Evidenca 4:Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive në Shqipëri (2021 - 2024)
[20] Evidenca 5: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[21] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[22] Evidenca 9: Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit
[23] Evidenca 10: Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet
[24] Evidenca 12: Udhëzimi Nr. 1, datë 14.1.2020 *(ndyshuar me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020, nr.25 datë 28.12.2021 )*
[25] Evidenca 51: Statistika/ *Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[26] Evidenca 14: CV-të e lektorëve, *Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*, periudha 2018-2021.
[27] Evidenca 15: Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Dep. Financë - Kontabilitet, V.A 2020-2021
[28] Evidenca 16: Programet e studimit të ofruara nga Dep. Financë – Kontabilitet
[29] Evidenca 17: Kualifikimi dhe kërkimi shkencor i PAE në 5 vitet e fundit
[30] Evidenca 20: Regullore e Fakultetetit të Biznesit
[31] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*

| | |
|---|---|
| të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushen akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të pakten një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | **Po.** Fusha e përgjithshme e *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*, por edhe fusha specifike përputhen me fushën akademike kërkimore të njësisë bazë që administron këtë program[34]. Hartimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare europiane[35 36]. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere | **NA** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsirnit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentet e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | **Po.** Modaliteti i zhvillimit të *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* krijon mundësinë punësimit gjatë periudhës së studimit [37]. Përpos mundësisë së angazhimit profesional gjatë periudhës së studimeve, njësia kryesore ofruese e këtij programi disponon marrëveshje ku studentëve të angazhuar apo diplomuar në këtë program studimi i mundësohen trajnime sipas nevojës/kërkesës[38], sikurse në vazhdimësi janë realizuar njoftime në rrjetet sociale sipas natyrës së trajnimit për studentët dhe të interesuarit[39]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.3<br>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda | **Po.** Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UAMD-së [40 41 42 43 44] dhe Udhezimet e MASR për organizimin e programeve të studimit[45]. Detyrat dhe |

[32] Evidenca 18: Kodifikimi i programeve të studimit, UAMD
[33] Evidenca 19: Shkresë Nr. Prot. 968 Datë 02.12.2021_Fushat kërkimore shkencore për Dep. Financë – Kontabilitet
[34] Evidenca 19: Shkresë Nr. Prot. 968 Datë 02.12.2021_Fushat kërkimore shkencore për Dep. Financë – Kontabilitet
[35] Evidenca 1: Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[36] Evidenca 18: Kodifikimi i programve të studimit UAMD
[37] Evidenca 28: Kalendari Mësimor Fakulteti i Biznesit/Cikli i II-të i Studimeve/V.A. 2020-2021/sem.2
[38] Evidenca 23: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve
[39] Evidenca 24: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_platforma sociale facebook
[40] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[41] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[42] Evidenca 20: Regullore e Fakultetetit të Biznesit
[43] Evidenca 26: Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet
[44] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD
[45] Evidenca 12: Udhëzimi Nr. 1, datë 14.1.2020 *(ndyshuar me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020, nr.25 datë 28.12.2021 )*

| | |
|---|---|
| institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në njësinë që implementon programin e studimit dhe në Rregulloren mësimore të programit[46] te studimit janë të përcaktuara qartë roli dhe detyrat e njësisë bazë, përgjegjësit te grup-lëndëve/koordinatorit të programit, të lektoreve etj, si dhe analiza e ecurisë së programit[47]. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. | **Po.** Qasja, përmes të cilës UAMD-ja ka zgjedhur të zhvillohet, ka si objektiva përparimin e vetvetes, shoqërisë dhe partnerëve, përmes kontributit shumëkahësh që sjellin marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe, publike dhe private vendase dhe/ose të huaj[48]. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | **Po.** Njësia bazë ofruese e *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*, është e angazhuar në shfrytëzimin e të gjitha marrëveshjeve të cilat kanë në fokus fushën e programit të studimit[49] [50] [51]. Ndër objektivat e shfrytëzimit të këtyre marrëveshjeve, në funksion të *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*, janë:<br>- Të mësuarit përmes të bërit (praktikave profesionale)<br>- Ofrimin e praktikave bashkëkohore dhe ndërkombëtare në fushën e financës dhe kontabilitetit (Trajnime/Leksione të hapura/Etj.)<br>- Ndërlidhja e programit me tregun e punë (Panairi Vjetor i Punës)<br>- Incentivimin e të rinjve në thellimin e kërkimeve shkencore përmes aksesit të lirë dhe projekteve/konkurseve të përbashkëta<br>- Arsimim dhe përvojë ndërkombëtare (studime semestrale Erasmus, trajnime, mësimdhënie e PAE jashtë vendit)<br>- Zhvillimi i projekteve të përbashkëta ku studenti të jetë *aktori kryesor*.<br>- Etj[52] [53] [54] [55] [56] [57] [58] [59]. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është relativisht i ri. Departamenti Financë-Kontabilitet ka nisur ta ofrojë gjatë një periudhe të vështirë në vend dhe jashtë tij (si pasojë e Tërmetit 2019 dhe Covid-19), ndaj produktiviteti i marrëveshjeve në kontekstin e këtij programi nuk është realizuar ende, megjithatë departamenti gëzon eksperiencë në vlerësimin e përfitimeve të marrëveshjeve për programet që ai ofron.[60] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

46 Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
47 Evidenca 94: Ecuria e Programit të Studimit *Master i Shkencace në Financë-Kontabilitet*
48 Evidenca 22: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve
49 Evidenca 22: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve
50 Evidenca 23: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve
51 Evidenca 36: Analiza e Marrëveshjeve të Departamentit F-K
52 Evidenca 30: Model i Zhvillimit i të Praktikës Mësimore
53 Evidenca 31: Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit
54 Evidenca 32: Trajnime dhe mobilitete Erasmus_PAE
55 Evidenca 33: Pjesëmarrjet në programet Erasmus + V.A. 2021-2022
56 Evidenca 34: Abonim në librarinë digjitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF
57 Evidenca 35: "Konkursi i Punimeve Kërkimore" – 2 në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF
58 Evidenca 24: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_platforma sociale facebook
59 Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
60 Evidenca 36: Analiza e Marrëveshjeve të Departamentit F-K

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është hapur dhe riorganizuar në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi ka në total ka 120 kredite (ESTC). Kohëzgjatja normale është dy vite akademike dhe forma e studimit është me kohë të plotë[61 62 63 64 65 66]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është hartuar për të diplomuar studentet, të cilët dëshirojnë të zgjerojnë ekspertizën e tyrë në fushën e kontabilitetit dhe financës. Gjatë tre semestreve akademikë studentët zhvillojnë lëndë/module të cilat ofrojnë njohuri të thelluara në disiplinat përkatëse të financës dhe kontabilitetit, të gërshetuara me lëndë bazë ku përvetsojnë njohuri gjithëpërfshirëse akademike dhe aftësi praktike konkrete në zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme me të cilat mund të ndeshen në profesionin e tyre apo hulumtimet e mëtejshme. Në lëndët karakterizuese për përgatitje në disiplinën shkencore programi është i balancuar ndërmjet dy fushave, ndërsa studentit i ofrohet mundësia të zgjedhë ndërmjet dy fushave në lëndët ndërdisiplinore.<br>Semestri i fundit i programit i dedikohet aftësimit praktik dhe hulumtimeve e studimeve të thelluara për problematika/çeshtje/fenomene në fusha të specializuara studimi. [67]<br>Ky program studimi synon të formojë ekspertë dhe specialistë në një gamë të gjerë sektorësh dhe organizatash në fushat e biznesit, konsulencës dhe financave, dhe sigurojë një përgatitje të plotë për kërkime akademike në kontabilitet ose financë. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* i përmbahet legjislacionit vendas në fuqi për pëcaktimin e krediteve të praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllese[68 69 70].<br>Praktika profesionale ka 12 kreditë (ETCS), ekuivalente për studentin me 300 orë punë të rregulluara sipas Rregullores së Praktikës pranë Fakultetit të Biznesit[71].<br>Detyrimet Përmbyllese për programin *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* kanë 13 kreditë (ETCS), ekuivalente me 325 orë punë të studentit. |

[61] Evidenca 12: Udhëzimi Nr. 1, datë 14.1.2020 *(ndyshuar me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020, nr.25 datë 28.12.2021 )*

[62] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 *(ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 185 datë 25.03.2021)*

[63] Evidenca 38: Urdhër Nr. 654 datë 11.10.2018, Për Hapjen e Programit të Ciklit të Dytë, *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*, në UAMD

[64] Evidenca 39: Dosja elektronike e aplikimit për riorganizim për *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet, 2020,2022*

[65] Evidenca 20: Regullore e Fakultetetit të Biznesit

[66] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*

[67] Evidenca 40: Kalendari Mësimor Semestral VA 2018-2019, VA 2019-2020, VA 2020-2021

[68] Evidenca 12: Udhëzimi Nr. 1, datë 14.1.2020 *(ndyshuar me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020, nr.25 datë 28.12.2021 )*

[69] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 *(ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 185 datë 25.03.2021)*

[70] Evidenca 39: Dosja elektronike e aplikimit për riorganizim për *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet,2020, 2022*

[71] Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit

| | |
|---|---|
| | Përmbushja e Detyrimeve Përmbyllëse kërkon përgatitjen dhe mbrotjen e mikrotezës për një tematikë të caktuar të fushës së programit të studimit[72]. |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | **NA** |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psikopedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | **NA** |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | **NA** |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, *si dhe me të njëjtën emërtesë*, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | **NA** |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Referuar Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj, realizimi i kodifikimit të programeve të studimit, në zbatim të nenit 86 të Ligjit për Arsimin e Lartë, parashikohet të nis nga MAS në TM2-2023[73] [74]. UAMD ka realizuar një kodifikim të programeve sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane nën emërtimin, kodi i programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet është UAMD-MSH-70411-FKK[75]. |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | **NA** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[72] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[73] Evidenca 43: Vendim Nr. 621 datë 22.10.2021, Për Miratimin e *Strategjisë Kombëtare Për Arsimin 2021–2026* dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e Saj
[74] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015
[75] Evidenca 18: Kodifikimi i programeve të studimit, UAMD

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ofrohet nga Dep. Financë-Kontabilitet, njësi bazë e Fakultetit të Biznesit, UAMD. Dep. Financë-Kontabilitet përmbush të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet institucionale mbi të cilin është ngritur dhe funksionon[76] [77] [78] [79] [80].<br>Departamenti Financë-Kontabilitet organizohet mbi bazën e grup-lëndëve në dy fushat kryesore, Financë dhe Kontabilitet. Stafi akademik efektiv i departamentit është i ndarë në grupe mësimore kërkimore shkencore sipas fushave përkatëse[81]. Për çdo program studimi është caktuar një koordinator përgjegjës[82]. Në departament, kërkimi shkencor monitorohet nga koordinatori për kërkimin shkencor i zgjedhur nga stafi i departamentit[83]. Departamenti Financë-Kontabilitet përbëhet nga 16 anëtarë, nga të cilët një Prof.Dr., një Prof.Asc.Dr., një Doc.Dr., tetë Doktor Shkencash, pesë Doktorantë (në IAL të huaja)[84].<br>Hapja/ riorganizimi i *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.<br>Stafi akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi ndër vite është alternuar ndërmjet PAE dhe PAK[85].<br>*Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* i nënshtrohet vlerësimit në mbështetje të Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë pranë UAMD-së[86]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike etj. | **Po.** Fakulteti i Biznesit përmbush të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi angazhimin e personelit akademik ndihmës/administrativ për realizimin në *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*[87] [88].<br>Krahas koordinatorit të programit dhe përgjigjësit të njësisë bazë, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e programit, njësia kryesore mbështet stafin akademik në zhvillimin e programit përmes sekretarisë mësimore dhe laborantëve. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ndiqet nga koordinatori i caktuar në mbledhje të posaçme të njësisë bazë. Përgjegjësitë e koordinatorit për programin e studimit janë të përcaktuara në përputhje legjislacioni në fuqi dhe aktet e tjera institucionale[89] [90] [91] [92] [93]. |

[76] Evidenca 47: VKM Nr. 685 datë 25.08.2010, Për Riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[77] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015
[78] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[79] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[80] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[81] Evidenca 48: Ngritja e grupeve mësimore-kërkimore Departamenti Financë-Kontabilitet.
[82] Evidenca 44: Memo datë 19.04.2019, Për caktimin e Koordinatorit të *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet;* Memo Nr. Prot. 371datë 21.04.2021 Për caktimin e Koordinatorit të *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[83] Evidenca 49: Koordinatori i kërkimit shkencor pranë Këshillit të Kërkimit Shkencor – UAMD nga Dep. Financë-Kontabilitet
[84] Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[85] Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[86] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD
[87] Evidenca 46:MAS/ Udhëzim Nr. 27 datë 29.12.2017
[88] Evidenca 20: Regullore e Fakultetetit të Biznesit
[89] Evidenca 44: Memo, datë 19.04.2019, Për caktimin e Koordinatorit të *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet;* Memo, Nr. Prot. 371datë 21.04.2021, Për caktimin e Koordinatorit të *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[90] Evidenca 45: VKM Nr. 824 datë 24.12.2021 për miratimin e "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë"
[91] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD / neni 10
[92] Evidenca 46:MAS/ Udhëzim Nr. 27 datë 29.12.2017
[93] Evidenca 50: Korrespondenca elektronike e Koordinatorit të Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet dhe Përgjegjësit të Dep. Financë-Kontabilitet për V.A. 2020-2021

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | **Po.** I gjithë informacioni për *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* qarkullon dhe arkivohet në mbështetje të Rregullores për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD[94]. Një informacion i përgjithshëm së bashku me kurrikulën dhe organizimin e programit është i publikuar në faqen zyrtare të univesitetit (www.uamd.edu.al ). |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* përmban në brendi të planit mësimor të gjithë informacionin e nevojshëm, referuar legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore institucionale[95] [96] [97] [98] [99]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | **Po.** Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Departamenti Financë-Kontabilitet përcakton dhe bën publike kriteret e përgjitshme dhe specifike të përzgjedhjes të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve çdo vit akademik, me vendimet përkatëse të Senatit Akademik. Për trasnferimin dhe ekuivalentemin e programeve departamenti i përmbahet legjislacionit në fuqi dhe akteve tjera institucionale[100] [101] [102] [103]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit | **Po.** Syllabuset e këtij programi janë të përgatitur në përputhje me VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 dhe janë reflektuar ndryshimet për VKM pasardhëse[104]. Syllabuset përmbajnë të gjithë komponentët e kërkuar, në ndihmë të orientimit të studentit mbi për lëndën që po zhvillojnë në këtë program studimi[105]. |

[94]Evidenca 52: Rregullore për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD/Vendim S.A. Nr. 141 datë 27.09.2018

[95] Evidenca 13: Udhëzimi Nr 37 datë 29.12.2017

[96] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 (ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 185 datë 25.03.2021)

[97] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*

[98] Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet

[99] Evidenca 97: Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023

[100] Evidenca 55: Udhëzim Nr. 10, datë 15.5.2019 "Për Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë" (*Ndryshuar me Udhëzimin nr. 17, datë 30.7.2019; nr. 19, datë 10.9.2019, nr. 15, datë 26.5.2020, nr. 17, datë 23.6.2020, nr. 25, datë 1.12.2020; nr. 11, datë 2.6.2021*)

[101] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015

[102]Evidenca 56: Udhëzim Nr. 52, datë 03.12.2015 "Për Përcaktimin e Niveleve të Gjuhëve të Huaja dhe të Testeve Ndërkombëtare, për Pranimet në Programet e Studimit të Ciklit të Dytë dhe të Tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë"

[103] Evidenca 59: Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kritereve të Pranimit për Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2023-2024

[104] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 (ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 185 datë 25.03.2021)

[105] Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet

| | |
|---|---|
| brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është një program i cili i përshtatet më së miri mjedisit akademik dhe atij praktik vendas dhe të huaj. Lëndët/modulet e këtij programi mundësojnë një nivel të lartë të të kuptuarit të teorisë dhe praktikës së kontabilitetit dhe financës, të domosdomoshme për një karrierë të suksesshme në këto fusha. Por, në mënyrë të veçantë ky program siguron njohuritë themelore të nevojshme për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve në fushat përkatëse. Përmbajtja e programit dhe lëndëve/moduleve të ofruara janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë[106] [107]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | **Po.** *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* gëzon të gjithë elementët e cituara në kriter. Ky program studimi është organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht shkencor dhe atë praktik, për arritjen e objektivave të programit (njohuri të thelluara të fushës që mundësojnë vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë "*Doktoraturë*" dhe/ose rritjen në karrierën e profesionale).<br>Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. Struktura e programit të studimit është ndërtuar dhe shkon në pajtim me Ligjin për Arsimit e Lartë (80/2015) dhe aktet nënligjore në fuqi[108] [109] [110]. |
| **Kriteri 2.** Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | **Po.** Programi i studimit, palni mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*, dhe kreditet për secilën prej tyre mundësojnë arritjen e objektivave akademike të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Organizimi i veprimtarisë mësimore në *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* në 2 (dy) vite akademike të ndarë dhe 4 semestra, së bashku me kreditet dhe vlerësimet e lëndëve është prezantuar dhe më lart në standardin II.3, kriteret 2 dhe 3. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme | **Po.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin master dhe është i përafërt gjithashtu dhe me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ngarkesa që ai përmban në orë mësimore (3000 orë) dhe kredite (120 ECTS), i përmbahen përcaktimeve |

[106] Evidenca 39: Dosja elektronike e aplikimit për riorganizim për *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet, 2020, 2022*

[107] Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet/ Tabela 14 - Syllabusi " Auditim i Pasqyrave Financiare" V.A. 2019-2020 dhe 2020-2021.

[108] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015

[109] Evidenca 12: Udhëzimi Nr. 1, datë 14.1.2020 *(ndyshuar me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020, nr.25 datë 28.12.2021 )*

[110] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 *(ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 185 datë 25.03.2021)*

| | |
|---|---|
| ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | ligjore për këtë cikël studimi dhe e përafron atë me programe të tjera të ngjashme ndërkombëtare[111 112 113]. |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | **Po.** Për të mundësuar arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve, programi i studimit ofron një ndërthurje midis formimit teorik dhe praktik, duke u bazuar edhe në praktikat më të mira të universiteteve te huaja duke mundësur në këtë mënyrë edhe transferim dhe mobilitet të studimeve[114]. |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | **Po.** Departamenti Financë-Kontabilitet i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes dhe miratimit të syllabusit në fillim të çdo viti akademik. Syllabuset përgatiten duke respektuar formatin tip dhe lirinë akademike[115 116]. Syllabuset janë të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme më qëllim që studentët të marrin njohuritë e nevojshme teoriko-profesionale, në përshtatje me tregun e punës[117 118]. |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara | **Po.** Në përputhje me objektivat për programe studimi të ciklit të dytë, programi i studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*", synon të formojë ekspertë dhe specialistë në një gamë të gjerë sektorësh dhe organizatash në fushat e biznesit, konsulencës dhe financave, dhe sigurojë një përgatitje të plotë për kërkime akademike në kontabilitet ose financë[119 120]. Ky progam studimi edhe pse me karakter multidisiplinor ofron njohuri të përgjithshme praktike, në përshtatje me tregun e punës[121 122]. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | **Po.** Institucioni dhe Departamenti Financë-Kontabilitet, ka mundësuar që përmes përmbajtjes së programeve të studimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerët, studentët të kenë mundësi të vijimësisë së studimeve dhe punësimin e tyre duke iu përshtatur nevojave të tregut[123 124 125]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

[111] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, Për Elementët e Programeve të Studimit të ofruara nga IAL-të *(ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 185 datë 25.03.2021)*
[112] Evidenca 97: *Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023*
[113] Evidenca 98: Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombetare *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*
[114] Evidenca 98: Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombetare *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*
[115] Evidenca 8: Dosja për hapjen e programit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*: Datë 25 / 05 /2018
[116] Evidenca 39:Dosja elektronike e aplikimit për riorganizim për *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet, 2020, 2022*
[117] Evidenca 94: Ecuria e Programit të Studimit *Master i Shkencace në Financë-Kontabilitet*
[118] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.2021-2022//Sem.3
[119] Evidenca 12: Udhëzimi Nr. 1, datë 14.1.2020, "Për Dokumentacionin Dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e IAL-ve,..., Programeve të Studimit, ..." *(ndyshuar me udhëzimin nr. 22, datë 3.9.2020, nr. 23, datë 28.9.2020, nr.25 datë 28.12.2021 )*
[120] Evidenca 13: Udhëzimi Nr 37 datë 29.12.2017, "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë"
[121] Evidenca 39: Dosja elektronike e aplikimit për riorganizim për *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*
[122]
[123] Evidenca 22: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve
[124] Evidenca 36: Analiza e Marrëveshjeve të Departamentit F-K
[125] Evidenca 23: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** | | | |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* u hap për të plotësuar një nevojë të tregut të punës në këto fusha pas një kohe të gjatë mungese dhe nevoje. Fakulteti i Biznesit (Dep. Financë-Kontabilitet) që në hapje të tij dhe deri në vitin 2018 ka ofruar programe të ciklit të parë të studimeve Bankë-Financë dhe Financë-Kontabilitet, ndërsa në ciklin e dytë të Studimeve Master Profesional Bankë-Financë (që nga viti 2010), Master i Shkencave Bankë-Financë dhe Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Rrezikut. Në një kohë kur tregu karakterizohet nga forma të ndryshme sipërmarrjesh të sektorit publik dhe atij privat (financiar dhe jofinanciar). | | | |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | **Po.** Insitucioni përmes takimeve dhe komunikmit të vazhdueshëm me studentët përfshin edhe këta të fundit në përmirësimin e programit të studimit[126] [127]. Kjo realizohet përmes inkurajimit të studentëve në perfshirjen e tyre në diskutime, propozime të cilat merren më tej në konsideratë dhe reflektohen nëse janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit[128] [129]. | | | |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | **Po.** UAMD dhe Fakulteti i Biznesit në kuadër të përmirësimit dhe riorganizimit të programeve të posaçme të studimit, kontakton me grupet e interesit, qofshin publike apo private[130] duke marrë në konsideratë nevojat specifike lokale apo dhe më gjerë, të cilat vijnë në ndihmë të studentëve për të qënë më afër nevojave të tregut [131]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të | **Po.** Programi i studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi që përcakton standardet karakterizuese të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale dhe shkencore që karakterizojnë profilin e programit të studimit[132] [133] [134]. Këto |

[126] Evidenca 88: Pyetsori i Studentit, si e *drejtë* e shprehjes se mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit
[127] Evidenca 99:Analiza e tregut të punës *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*
[128] Evidenca 31: Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit
[129] Evidenca 91: Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit
[130] Evidenca 132: Raporti Alumni Network
[131] Evidenca 94: Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencace në Financë-Kontabilitet
[132] Evidenca 8: Dosja për hapjen e programit MSc Financë-Kontabilitet: Datë 25 / 05 /2018
[133] Evidenca 39: Dosja elektronike e aplikimit për riorganizim për *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*
[134] Evidenca 94: Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencace në Financë-Kontabilitet

| | |
|---|---|
| institucionit. | objektiva janë në përshtatje të plotë me planin e zhvillimit strategjik të UAMD-së[135 136], të Fakultetit të Biznesit[137], të Departamentit Financë-Kontabilitet [138] dhe të Programit të Studimit[139]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | **Po.** Nëpërmjet strategjisë dhe politikës që ndjek UAMD[140 141 142], Fakulteti i Biznesit[143] dhe Departamenti Financë-Kontabilitet [144], inkurajon stafin që të angazhohet në autonomi te plotë jo vetëm në aktivitetet e mësimdhënies, por edhe në aktivitete me karakter shkencor, social, kulturor, sportiv. Autonomia akademike konsiston në alternimin e formave të ndryshme në mësimdhënie, si: leksione të hapura nga lektorë të huaj/vendas, përfaqësues biznesesh ose institucionesh; vizita pranë bizneseve/institucioneve[145 146], aktivitetet shkencore, të cilat bëjnë të mundur edhe përfshirjen dhe aktivizimin më të madh të studenteve në mësim[147 148]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | **Po.** Në Rregulloren e UAMD-së, neni 32, studentët përcaktohen si subjekte që kanë të drejtën të kryejnë veprimtari kërkimore shkencore dhe krijuese krahas personelit akademik. Studentët kanë të drejtë, sipas Rregullores të kenë revistën e tyre shkencore[149]. Programi i studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* në përmbajtjen e tij parashikon përgatitjen e studimeve nga ana e studentëve në formën e detyrave të kursit ose projekteve të cilat prezantohen gjatë orëve të leksionit në auditor[150]. Fakulteti i Biznesit organizon çdo vit konferencën studentore dedikuar studentëve duke i nxitur dhe motivuar për të marrë pjesë me punimet e tyre shkencore[151 152 153]. Gjithashtu, studentët bëhen pjesë e vizitave studimore dhe kërkimore pranë bizneseve të cakuara në përputhje me tematikën e lëndës, organizuar këto nga stafi i Departamentit të Financë-Kontabilitet në përputhje me tematikën e lëndës përkatëse[154]. |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | **Po.** UAMD në vite ka mbështetur stafin akademik përmes instrumentave të ndryshëm, përfshirë ato financiarë, në rritjen e tyre akademike. Stafi akademik ka të drejtë të aplikojnë për financim pranë institucionit, për realizimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe projekteve.[155 156 157 158]. Në departamentin Financë-Kontabilitet disa prej lektorëve kanë qenë aktiv në botimin e artikujve me Scopus dhe pjesmarrjen në projekte si drejtues apo si anëtar [159]. |

[135] Evidenca 5: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[136] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[137] Evidenca 9: Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit
[138] Evidenca 10: Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet
[139] Evidenca 29: Plani Strategjik i Zhvillimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2019-2023
140Evidenca 5: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[141] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[142] Evidenca 101: Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD
[143] Evidenca 9: Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit
[144] Evidenca 10: Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet
[145] Evidenca 31: Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit
[146] Evidenca 91: Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit
[147] Evidenca 102: Ngritja e Grupeve të Punës në Projekte/Konferenca, etj, Fakulteti i Biznesit
[148] Evidenca 32: Trajnime dhe mobilitete Erasmus_PAE
[149] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[150] Evidenca 90: Metodat Interaktive të Mësimdhënies
[151] Evidenca 103: Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD
[152] Evidenca 102: Ngritja e Grupeve të Punës në Projekte/Konferenca, etj, Fakulteti i Biznesit
[153] Evidenca 92: Konferenca Studentore në Fakultetin e Biznesit
[154] Evidenca 31: Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit
[155] Evidenca 104: Mbështetja financiare nga UAMD për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore në FB
[156] Evidenca 105: VKM Nr.75, Dt 12.2.2018, Modeli i Financimit të IAL-ve publike dhe Kërkimit Shkencor
[157] Evidenca 106: Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor, UAMD
[158] Evidenca 107: Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore Shkencore në UAMD
[159] Evidenca 131: Raport Financiar për Shpenzimet dhe të Ardhurat e Realizuara për Vitin Akademik 2021-2022

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | **Po.** Vetë struktura e programit të studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*, ka krijuar mundësinë për bashkëpunime të mëtejshme me struktura të tjera kërkimore jo vetëm në aspektin mësimor, por edhe në atë të kërkimit shkencor[160 161 162 163 164]. Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit dhe UAMD mbështesin dhe inkurajojnë bashkëpunime të tilla duke organizuar edhe aktivitete të tjera me natyrë kërkimore-shkencore si konferenca, workshop-e ose seminare[165 166]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | **Po.** Drejtuesit në rang universiteti, Rektor, Dekan, Përgjegjës Departamenti dhe njësitë e tjera përbërëse, nxisin dhe inkurajojnë jo vetëm personelin akademik, por edhe studentët të bëhen pjesë e projekteve dhe kërkimeve shkencore, cituar kjo edhe në Seksionin III të Rregullores së UAMD-së[167 168]. Si rezultat, përfshirja e personelit dhe studentëve stimulon një frymë/klimë për përfshirje dhe zhvillime të mëtejshme në aktivitetet kërkimore shkencore[169 170]. |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | **Po.** Personeli akademik nxitet të kualifikohet dhe të bëhet pjesë e kërkimit shkencor, me qëllim që të përmirësojnë aftësitë dhe njohuritë, në funksion të programit të studimit. Përfshirja e tyre në programet e Erasmus-it dhe konferencat kombëtare, ndërkombëtare aftësojnë me tej personelin në drejtim të mësimdhënies[171]. Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë-Kontabilitet organizojnë një sërë aktivitetesh me karakter shkencor dhe mësimor, duke inkurajuar stafin dhe studentët të bëhen pjesë e tyre. Përfshirja e tyre në aktivitete të tilla ka bërë të mundur rritjen e aktiviteteve nga viti në vit. Madje, studentët kanë realizuar disa aktivitete të pavarura, me qëllim të përmbushjes së objektivave të progamit[172 173]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | **Po.** Programi i studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*është hartuar dhe ofrohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Ky program mundëson pajisjen me njohuri dhe kompetenca profesionale për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të burimeve njerezore në tregun e punës për të mirë menaxhuar ofertën dhe kërkesën e tregut[174 175 176 177 178]. Ky program është i hartuar në përputhje me kuadrin |

[160]Evidenca 5: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[161] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[162] Evidenca 9: Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit
[163] Evidenca 10: Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet)
[164]Evidenca 29: Plani Strategjik i Zhvillimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2019-2023
[165] Evidenca 102: Ngritja e Grupeve të Punës në Projekte/Konferenca, etj, Fakulteti i Biznesit
[166] Evidenca 103: Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD
[167] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[168] Evidenca 103: Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD
[169] Evidenca 102: Ngritja e Grupeve të Punës në Projekte/Konferenca, etj, Fakulteti i Biznesit
[170]Evidenca 108: Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD), UAMD, https://www.journal-uamd.org/index.php/IJRD
[171]Evidenca 17: Kualifikimi dhe kërkimi shkencor i PAE në 5 vitet e fundit
[172] Evidenca 91: Buletini i Aktiviteteve në Fakultetin e Biznesit, 2021-2022
[173] Evidenca 103: Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD
[174] Evidenca 98: Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombetare Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet
[175] Evidenca 132: Raporti Alumni Network

| | |
|---|---|
| | ligjor në fuqi që përcakton standardet karakterizuese të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale që karakterizojne profilin e programit të studimit në përputhje me nivelin e studimeve ku ofrohet dhe kërkesat e tregut të punës[179] [180] [181] [182]. Këto objektiva detajojnë njohuritë dhe aftësitë që studentët do të fitojnë përmes studimeve në këtë program dhe janë në përshtatje të plotë me planin e zhvillimit strategjik të Universitetit, të Fakultetit të Biznesit, të Departamentit Financë-Kontabilitet dhe të Programit të Studimit[183] [184] [185] [186] [187]. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | **N/A** |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe ëore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU*). | **N/A** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[176]Evidenca 99: Analiza e tregut të punës në hapje të programit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*
[177] Evidenca 24: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_Njoftim në faqet sociale për Trajnim/Punësim Deloitte
[178]Evidenca 68: Panairi i Punës dhe Karrierës, V.A. 2020-2021
[179] Evidenca 99: Analiza e tregut të punës në hapje të programit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*
[180] Evidenca 68: Panairi i Punës dhe Karrierës, V.A. 2020-2021
[181] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[182] Evidenca 101: Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD
[183]Evidenca 5: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2016-2020
[184] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[185] Evidenca 9: Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit
[186] Evidenca 10: Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet)
[187]Evidenca 29: Plani Strategjik i Zhvillimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2019-2023

# III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | **Po.** Rregullorja e UAMD-së[188] përcakton se elementët kryesorë të studimit janë: leksionet, seminaret, detyrat/projektet e kursit, esetë, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare të kursit, temat e diplomës. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm përgjatë gjithë semestrit. Rregullorja e UAMD-së[189] përcakton se forma e vetme e kontrollit të dijes në Universitetin "Aleksandër Moisiu" është provimi me shkrim. Për çdo kurs 10% e vlerësimit të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, sipas programit të kursit të miratuar. Format e mësimdhënies janë të parashikuara në syllabuset përkatëse për çdo lëndë[190]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ofron një kurrikul të pasur me lëndë/module të cilat janë në përputhje me natyrën dhe fushën e studimit[191]. Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar metoda të ndryshme inovative mësimdhënie dhe mësimnxënie[192]. Personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike. Në bazë të fushës dhe natyrës së programit të studimit si dhe feedback-ut të marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përveç atyre klasike si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte në grup, mjete audio-vizive etj. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | **Po.** Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UAMD lidhet me trajnimin e pedagogëve. Personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për tu njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes[193]. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studenti mendimin krijues, atë kritik, si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br><br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | **Po.** Personeli akademik i angazhuar në programin *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*, përveç titujve dhe gradave kanë edhe background profesional në këtë fushë dhe kualifikime/certifikata kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli akademik gjatë leksioneve/seminare përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, ku në varësi të tematikës përdor metodat tradicionale ose bashkëkohore të mësimdhënies. Këto metoda ndërthuren duke pasur herë në qendër studentin dhe herë pedagogun. Profili i personelit akademik në Departamentin Financë-Kontabilitet është në përputhje me nevojat e programit të studimit[194] [195].<br><br>Personeli akademik i angazhuar në *Programin e studimit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ka një eksperiencë të gjatë akademike si personel akademik me kohë të plotë pranë UAMD[196]. Rreth70% e personelit akademik[197] të angazhuar në këtë program studimi janë të punësuar me kohë të plotë në UAMD dhe kanë një eksperiencë disa vjeçare në këtë profesion[198]. Lëndët kanë në programin e tyre edhe një projekt individual ose |

[188] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[189] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[190]Evidenca 53:Syllabuset e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.* 2021-2022/Sem.3
[191] Evidenca 97:Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023
[192] Evidenca 90: Metodat Interaktive të Mësimdhënies
[193]Evidenca 32: Trajnime dhe mobilitete Erasmus_PAE
[194]Evidenca 17: Kualifikimi dhe kërkimi shkencor i PAE në 5 vitet e fundit
[195]Evidenca 14: CV-të e lektorëve, *Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*, periudha 2018-2021
[196]Evidenca 51: Statistika/ *Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[197]Evidenca 51: Statistika/ *Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[198]Evidenca 14: CV-të e lektorëve, *Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*, periudha 2018-2021

| | |
|---|---|
| | në grup që zhvillohet përgjatë kohëzgjatjes së semestrit nën mbikëqyrjen e personelit akademik të lëndës duke inkurajuar punën në grup midis studentëve, të menduarit kritik si dhe bashkëpunimin lektor-student[199]. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | **Po.** Sikurse u përmend edhe më sipër, përfshirja e studentëve dhe vjelja e mendimit të tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së personelit akademik dhe metodave të mësimdhënies është në qendër të vëmendjes së UAMD. Autoritetet drejtuese dhe përgjegjësit e departamenteve, pasi bëjnë verifikimet e nevojshme të shqetësimeve të ngritura, marrin masa konkrete me qëllim përmirësimin e situatës. Këto masa mund të lidhen me ndryshime në programin e një lënde të caktuar, me ndryshime të kurrikulës së programit, ose me ndryshim të personelit akademik që zhvillon lëndën, në rastin kur konstatohet se pedagogu nuk ka kompetencën dhe aftësitë e duhura për të vijuar angazhimin.<br>Studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet anketave dhe pyetësorëve, e cila është e parashikur në rregullore së NJSBC neni 6[200], si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakënaqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit parashikuar në Rregulloren e Fakulteti të Biznesit, neni 83[201]. Rezultatet e pyetësoreve bëhen të ditura në mbledhje departamenti, jepen sygjerime ose merren masa per permirësime në të ardhmen. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | **Po.** Rregullorja e UAMD-së [202] parashikon ngritjen e Njësisë se Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe të praktikave profesionale, procesin e kontrollit të dijeve, diplomimit, si dhe të veprimtarive administrative dhe financiare të Univesitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.<br>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni, kryesisht njësia bazë/Departamenti, vlerëson format e mësimdhënies dhe analizon performancën e këtij procesi. Për këtë -Departamenti[203], si strukturë që drejton programin, analizon periodikisht[204] [205];<br>-Çdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik;<br>-Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor[206] [207].<br>-Realizon dhe tërheq opinionin e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies[208].<br>Kontrollet e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga dekanati dhe departamenti identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësori i studentëve[209].<br>Gjithashtu, personeli akademik i mbështetur nga Institucioni dhe njësitë përgjegjëse ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për tu njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes[210]. |

[199]Evidenca 21: **Rregullore** e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[200]Evidenca 27: **Rregullore** e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD
[201]Evidenca 20: **Rregullore** e Fakultetit të Biznesit
[202] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[203]Evidenca 26: **Rregullore** e Departamentit Financë- Kontabilitet
[204]Evidenca 93: Analiza Vjetore 2018-2022
[205] Evidenca 94: Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencace në Financë-Kontabilitet
[206]Evidenca 17: Kualifikimi dhe kërkimi shkencor i PAE në 5 vitet e fundit
[207] Evidenca 15: Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Dep. Financë - Kontabilitet, V.A 2020-2021
[208]Evidenca 88: Pyetsori i Studentit, si e *drejtë* e shprehjes se mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit
[209]Evidenca 94: Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencace në Financë-Kontabilitet
[210]Evidenca 32: Trajnime dhe mobilitete Erasmus_PAE

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret, mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në rregulloren e programit të studimit/rregulloren e institucionit/rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët. | **Po.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në procedurat e vendosura në rregulloret e brendshme institucionale. Rregullorja e Përgjithshme e Universitetit është e publikuar në faqen zyrtare të UAMD-së dhe garanton zbatimin e tyre[211] [212] [213]. Rregullorja e Fakultetit dhe Rregullorja e Programit të Studimit, të cilat përmbajnë të gjitha cilësimet dhe përcaktimet në mënyrë me specifike dhe të detajuar mbi kriteret, mënyrat e testimit dhe procedurat e duhura te bëra në Rregulloren e Përgjithshme dhe në plotësim të saj, sigurojnë njohjen nga studentët dhe zbatimin e tyre në procesin mësimor[214] [215] [216]. Rregullorja e Përgjithshme e UAMD-së është e publikuar në faqen zyrtare të institucionit, ku studentët mund ta kenë në dispozicion për t'u sqaruar dhe qartësuar në çdo moment. Aspekte të rëndësishme të akteve të mësipërme rregullative dhe të tjera që mund t'i shërbejnë këtij procesi, publikohen në ambjentet e Fakultetit. Pedagogu tutor/mentor kujdeset në vazhdimësi për sqarimin e paqartësive që studentët mund të kenë [217]. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | **Po.** Në Rregulloren e Përgjithshme të UAMD-së dhe Rregulloret e tjera që plotësojnë atë, përcaktohet qartë detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/lënde me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit[218]. Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit që në fillim të procesit mësimor me sqarimin nga ana e pedagogut të lëndës të syllabus-it përkatës, i cili përmban të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale[219] [220]. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | **Po.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet nëpërmjet provimeve, testeve, detyrave të kursit, projekteve, diskutimeve në auditor, praktikës profesionale, etj, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të modulit/lëndës[221] [222]. Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, pohime, pyetje shpjeguese dhe ushtrime, në varësi të natyrës së lëndës[223]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

[211] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[212] Evidenca 21: **Rregullore** e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[213] Evidenca 20: **Rregullore** e Fakultetit të Biznesit
[214] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[215] Evidenca 21: **Rregullore** e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[216] Evidenca 20: **Rregullore** e Fakultetit të Biznesit
[217] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.2021-2022/Sem.3
[218] Evidenca 20: **Rregullore** e Fakultetit të Biznesit
[219] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[220] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.2021-2022//Sem.3
[221] Evidenca 25: **Rregullore** e UAMD-së
[222] Evidenca 21: **Rregullore** e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[223] Evidenca 71: **Rregullore** e Provimeve, Fakulteti i Biznesit

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | **Po.** Departamenti mbështet një strukturë të përshtatshme për të promovuar dhe siguruar mësimnxënien në mënyrë të vazhduar të studentëve. Vlerësimi në vazhdimësi i dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë zhvillimit të modulit/lëndës në detyrat dhe esetë të cilat zhvillohen gjatë semestrit dhe përmbajnë 10% të vlerësimit përfundimtar; në provimin e parë të ndërmjetëm (zhvillohet javën e shtatë ose të tetë), që përmban 40% të vlerësimit përfundimtar dhe në provimin përfundimtar që përmban 50% të vlerësimit përfundimtar.<br>Ky sistem i integruar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale i nxit dhe motivon studentët të mësojnë në vazhdimësi gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të modulit/lëndës, në auditor dhe në orët e studimit të pavarur dhe i drejton ata të përmirësohen sistematikisht. Diversiteti i formave vlerësuese u jep mundësi studentëve dhe pedagogëve të plotësojnë boshllëqet dhe paqartësitë në kohë me qëllim përfitimin e njohurive të plota deri në përfundim të lëndës/modulitt. Kjo gjithashtu mundëson një vlerësim më të mirë të progresit të studentit në dijet e tij të fituara nga ndjekja e programit. Kjo mënyrë e integruar e vlerësimit i jep mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të modulit/lëndës[224] [225] [226] [227]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | **Po.** Kriteret, kërkesat dhe procedurat që shërbejnë për testimin e aftësive të studentëve parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të UAMD-së, neni 72 dhe rregulloret e tjera në plotësim të saj, të miratuara prej organeve kolegjale të institucionit[228] [229]. Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur format e ndryshme të abuzimit, institucioni ka zbatuar projekte pilot për testimin e sistemeve elektronike me bazë kodimin e tezave të studentëve dhe aktualisht, aplikon projektin Clean Score sipas marrëveshjes midis Albanian-American Development Foundation dhe Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës[230]. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | **Po.** Mënyra e vlerësimit është e pasqyruar në syllabus-in e çdo kursi në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatore Fakulteti i Biznesit/ UAMD[231] [232]. |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | **Po.** Njohuritë e studentëve vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme përmes diskutimeve në klasë, detyrave dhe provimeve. Vlerësimi i vazhdueshëm i ndihmon studentët të kuptojnë ku kanë vështirësi ose boshllëqe, si mund të përmirësojnë përvetësimin e modulit/lëndës dhe u siguron lektorëve të dhëna në lidhje me mësimdhënien efektive. Studentët ballafaqohen me vlerësimin në teste/provime dhe gjithashtu, ju komunikohet vlerësimi për angazhimin në diskutime dhe për detyrat e kursit përmes një bashkëbisedimi, ku pedagogu thekson mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të mësimnxënies nga ana e studentëve dhe merr feed-back për pretendimet e studentëve lidhur me procesin. Fakulteti i Biznesit garanton të drejtën e çdo studenti për tu njohur me vlerësimin si dhe për të marë një informacion të detajuar nga personeli akademik i kursit në lidhje me mënyrën e vlerësimit së bashku me identifikimin e gabimeve që studenti ka bërë në testim. Për çdo provim, |

[224] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[225] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[226] Evidenca 71: Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit
[227] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.2021-2022//Sem.3
[228] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[229] Evidenca 71: Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit
[230] Evidenca 95: Trajnime CleanScore
[231]Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[232] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.2021-2022/Sem.3

| | |
|---|---|
| | personeli akademik i kursit informon studentët për ditën, sallën dhe orarin kur studentët mund të bëjnë ballafaqimin e rezultateve të provimit. Pasi ka bërë ballafaqimin e rezultateve me studentët, personeli akademik duhet të dorëzojë pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve përfundimtare (dhe në sistem) së bashku me provimet jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit neni 69, pika 7 dhe neni 72, pika 3i[233]. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | **Po.** Departamenti dhe personeli akademik respektojnë Rregulloren e UAMD-së dhe Kodin e Etikës së UAMD-së neni 17, pika F; neni 23; neni 18, pika j mbi evitimin e plagjiaturës[234] dhe kopjimit Rregullore e UAMD-së, neni 70, pika 3, 4, 5, 6, 7[235]. Ata orientojnë studentët lidhur me literaturën e nevojshme si dhe këshillojnë kryerjen e detyrës së kursit dhe temës së diplomës duke i konsideruar këto masa të nevojshme për të evituar plagjiaturën.<br>Infrastruktura logjistike që mund të sigurojë plotësisht këtë proces mungon dhe kjo detyrë kërkon të garantohet në Universitet infrastruktura e nevojshme për kontrollin e plagjiaturës. Rëndësi e veçantë i është dhënë konceptimit dhe formatimit të detyrave të kursit individuale apo në grup, ku pedagogu bën një vlerësim të detajuar dhe të argumentuar të cilësise së punimit, sipas komponentëve të zhvillimit të saj. Ky vlerësim i shërben studentit për të kuptuar se si mund të përmirësojë punën e tij. Thelbësore në suksesin e misionit edukues të UAMD-së është përkushtimi ndaj parimeve të integritetit akademik. Çdo anëtar i komunitetit akademik është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë. |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | **Po.** Pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpermjet provimeve, teste me pyetje alternative, quize, prezantime ne grup ose individuale, etj. Diversiteti i formave vlerësuese u jep mundësi pedagogëve të vlerësojnë saktë njohuritë e përfituara nga studentët nga ndjekja e programit. Procesverbalet e vlerësimit dorëzohen në Sekretari në afatet e përcaktuara qartë në Rregulloren e UAMD-së neni 69, pika 7 dhe Rregulloren e programit të studimit[236] [237]. |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | **Po.** Rregullorja e Përgjithshme e UAMD-së neni 69, pika 7, neni 71, Rregullorja e programit të studimit si dhe Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit garantojnë të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe të drejtën për rishikim të vlerësimit në bazë të një procedure të përcaktuar qartë[238] [239] [240]. |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | **Po.** Çdo kërkesë ose ankimim shqyrtohet duke respektuar me korrektësi procedurat që përcakton Rregullorja e UAMD-së, neni 71 dhe dokumentacioni dorëzohet në Sekretarinë e Fakultetit e cila administron dokumentacionin sipas ligjshmërisë në fuqi [241] [242].<br>Në rast se studenti, edhe pas ballafaqimit të rezultateve me personelin akademik, nuk është i bindur për saktësinë e vlerësimit atëhere ai ka të drejtë që brenda afateve të parashikuara në rregullore të paraqesë në dekanat një kërkesë me shkrim për rishikim të vlerësimit të provimit. Në rastet kur kërkesa miratohet atëhere departamenti ngre një komision vlerësimi të përbërë nga personel akademik të asaj disipline. Personeli akademik i seksionit/kursit nuk mund të jetë anëtar i komisionit të rishikimit. Komisioni përcakton ditën dhe orën e rishikimit duke informuar studentin dhe personelin |

[233] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[234] Evidenca 7: Kodi i Etikës, UAMD
[235] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[236] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[237] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[238] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[239] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*
[240] Evidenca 71: Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit
[241] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[242] Evidenca 21: Rregullore e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet*

| | |
|---|---|
| | akademik të seksionit/kursit dhe bën rivlerësimin e tezës në prezencën e tyre. Komisioni del me një vendim për rezultatin e vlerësimit neni 71[243]. E gjithë procedura ruhet në protokollin e Fakultetit të Biznesit. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.4<br>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore te studentët | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është në përputhje me misionin dhe qëllimet që UAMD dhe njësitë përbërëse të tij (Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti Financë-Kontabilitet) ofrojnë një edukim akademik dhe profesional sipas standardeve më të larta akademike bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombetare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë [244 245].<br><br>*Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* përpiqet që të përforcojë aftësitë analitike, prezantuese, aftësitë negociues dhe menaxhuese në situata konkuruese, të fitojnë aftësi të punës në grup etj. Përfitimi i këtyre aftësive është në fokus të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke punuar me studentët raste studimi dhe detyra kursi në mënyrë individuale dhe në grup, dhe në vazhdimësi në procesin e zbatimit të prgramit të studimit. Për më tepër, nëpërmjet një programi specifik, të parashikuar në Planin Mësimor të Programit të Studimit, që përmban program plotësues për lëndët që i mungojnë formimit të studentëve, sigurohet shmangja e vështirësive në avancimin e njohurive që përfitohen nga ky program studimi[246 247]. Theks i veçantë vihet tek praktika profesionale e cila zhvillohet në subjektet, aktiviteti i të cilave përputhet me natyrën e programit të studimit dhe po kështu, tek punimi i mikrotezës që i jep mundësi studentit të avancojë njohuritë dhe aftësitë profesionale[248 249 250]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ofrohet nga Departamenti Financë-Kontabilitet, pranë Fakultetit të Biznesit që prej vitit akademik 2018-2019. Fusha e përgjithshme e *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*, por edhe fusha specifike përputhen me fushën akademike kërkimore të njësisë bazë që administron këtë program[251]. *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është hartuar për të diplomuar ata të cilët dëshirojnë të zgjerojnë ekspertizën e tyre në fushën e kontabilitetit dhe financës. Ky program studimi synon të formojë ekspertë dhe specialistë në një gamë të gjerë sektorësh dhe organizatash në fushat e biznesit, konsulencës dhe financave, dhe sigurojë një përgatitje të plotë për kërkime akademike. *Programi* |

243 Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
244 Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
245 Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
246 Evidenca 97: Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023
247 Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
248 Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
249 Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
250 Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
251 Evidenca 19: Vendim Nr. 80, Datë 02.02.2018_Fushat kërkimore shkencore për Dep. Financë - Kontabilitet

| | |
|---|---|
| | *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është një program i cili i përshtatet më së miri mjedisit akademik dhe atij praktik vendas dhe të huaj. Lëndët/modulet e këtij programi mundësojnë një nivel të lartë të të kuptuarit të teorisë dhe praktikës së kontabilitetit dhe financës, të domosdomoshme për një karrierë të suksesshme në këto fusha. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | **Po.** Çdo pedagog analizon në përfundim të lëndës çështje të përditësimit të temave mësimore që kanë të bëjnë me kompleksitetin dhe sigurimin e njohurive komplementare për njohuri të plota dhe profesionale të studentëve. Në grupet mësimore diskutohen çështje të ndryshme për përmirësimin në vazhdimësi të syllabus-it[252]. Çështje të veçanta të përmirësimit në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, diskutohen edhe në departament. Në fund të cdo semestri, lektorët nën kordinimin e koordinatorit të programit të studimit dhe drejtuesit të njësisë bazë bëjnë orientimet e nevojshme për detyrimet përmbyllëse. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | **Po.** Leksionet zhvillohen mbi bazën e literaturës themelore të përcaktuar në Syllabus[253], duke i dhënë studentëve informacionet kryesore, teoritë dhe trajtimet apo analizat e bëra nga studjuesit dhe ekspertët më të njohur të fushës. Biblioteka e UAMD-së është anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike on line në Shqipëri dhe kjo i siguron stafit dhe studentëve qasje në tekste dhe literaturën e nevojshme si mundësi reale për efektivitetin e mësimdhënies. UAMD-së është në proces të përhapjes së përdorimit të Moodle, një platformë e të mësuarit e dizenjuar për t'iu mundësuar mësimdhënësve, administratorëve dhe studentëve, krijimin e ambienteve të të mësuarit të personalizuar. Anëtarë të stafit tonë akademik në mënyrë vetjake kanë përdorur këtë qasje për studentët në programe të caktuara. Ndërveprimi me studentët është një proces interaktiv i përhershëm. Në lëndë të caktuara organizohen edhe vizita në biznese dhe sipërmarrje private, në institucione publike vendase dhe të huaja. Pjesë e procesit të mësimdhënies janë edhe orët e leksioneve të hapura që organizohen nga Departamenti dhe synojnë që të sjellin eksperiencën praktike të organizatave publike apo drejtuesve të rëndësishëm të sipërmarrjes private nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | **Po.** Përgjatë vitit akademik, Fakulteti i Biznesit organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj, për studentët e saj[254 255 256 257 258 259]. Këto aktivitete mund të drejtohen nga personeli akademik i Fakultetit të Biznesit (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor.Aktivitetet që kanë lidhje me *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* janë trajnime, leksione të hapura, orë informuese për mundësi punësimi apo mundësi trajnimesh jashtë UAMD etj[260 261].Kombinimi i dijes në auditor me punën e pavarur të studentit |

[252] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022//Sem.3
[253] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022//Sem.3
[254] Evidenca 72: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_ "Drejt një rruge që sa ka nisur..., praktika dhe kërkimi, roli tyre në rritjen profesionale"
[255] Evidenca 31: Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit
[256] Evidenca 24: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_Njoftim në faqet sociale për Trajnim/Punësim Deloitte
[257] Evidenca 77: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_Takim për Lidhjen Marrëveshje mes FB dhe Shoqatës së Sigurimeve në Shqipëri për praktika profesionale, kërkim shkencor dhe mundësi punësimi, 8 Maj 2021
[258] Evidenca 79: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_WB6 CSOs for youth Employment Support
[259] Evidenca 74: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_Informimi dhe Asistimi i Studentëve/Palëve të interesuara për Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet, V.A. 2019-2020
[260] Evidenca 72: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_ "Drejt një rruge që sa ka nisur..., praktika dhe kërkimi, roli tyre në rritjen profesionale"

| | |
|---|---|
| | nëpërmjet temave individuale apo në grup, të orientuar në situata ose problematika reale, mundësojnë përgatitjen e tyre për të thelluar dijet dhe aftësitë praktike. Studentët janë inkurajuar nga pedagogët dhe nën kujdesin e tyre kanë përgatitur punime të cilat i kanë prezantuar në Konferencat e organizuara me tematikë që lidhet me programin e studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* e më gjerë [262] [263]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | **Po.** Në Rregulloren e UAMD-së, neni 32, studentët përcaktohen si subjekte që kanë të drejtën të kryejnë veprimtari kërkimore shkencore dhe krijuese krahas personelit akademik. Studentët kanë të drejtë, sipas Rregullores UAMD-së, neni 34, pika 3, të kenë revistën e tyre shkencore[264]. Studentët kanë të drejtë të aplikojnë për fiancim pranë institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare për realizimin e veprimtarisë kërkimore shkencore dhe krijuese, neni 32 nën logon e UAMD-së[265].Shpenzimet e pjesmarrjes dhe të botimit të temave të konferencës studentore sponsorizohen nga projektet që ka Institucioni. Gjithashtu, në UAMD organizohen edhe konkurse për projekte dhe ide innovative dhe realizohen me mbështetje këshilluese nga stafi akademik, por këto sponsorizohen nga vetë studentët ose ne raste të vecanta nga partnerë të tjerë që ka marrveshje Fakulteti i Biznesit[266]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe e bën atë publike. | **Po.** Departamenti Financë-Kontabilitet harton paraprakisht procedurat dhe afatet kohore, të udhëzimeve mbi strukturën si dhe të rregullave të ndryshme për procesin e mbrojtjes së mikrotezës[267] [268] dhe i njeh studentët me këtë dokument i cili u vjen atyre në ndihmë në mënyrë që të përfundojnë me sukses të gjitha hapat deri në mbrojtje të mikrotezës për programin e studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* [269]. Studimet e programit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* përmbyllen me punim mikroteze.[270] Për të marrë pjesë në mbrojtjen e mikrotezës studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e tjera të kurrikulës[271] sipas të drejtave dhe detyrime të përcaktuara në Regulloret e UAMD[272] [273] [274] [275] [276]. Ai mund të regjistrohet vetëm pasi shlyerja e këtyre detyrimeve konfirmohet nga sekretaria mësimore e FB-se[277] |

[261] Evidenca 31: Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit
[262] Evidenca 93: Analiza Vjetore 2018-2022
[263] Evidenca 35: "Konkursi i Punimeve Kërkimore" – 2 në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF
[264] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[265] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[266] Evidenca 35: "Konkursi i Punimeve Kërkimore" – 2 në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF
[267] Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[268] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[269] Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[270] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[271] Evidenca 97: Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023
[272] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[273] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[274] Evidenca 26: Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet
[275] Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | **Po.** Strukturat përgjegjëse, përgjegjësi i Departamentit Financë-Kontabilitet, personeli akademik si dhe sekretaria mësimore asistojnë studentët duke u vënë atyre në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të hapave që duhen ndjekur për realizimin e procesit të mbrojtjes së mikrotezës në programin e studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*[278]. Sipas rregullores së UAMD-së dhe rregulloreve mbështetëse[279 280 281 282 283] studentëve ju jepet informacioni nga strukturat përgjegjëse nëpërmjet orientimit në auditore, njoftimeve me e-mail si dhe njoftime në rrjetet sociale[284]. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | **Po.** Deri më tani, në programin e studimit *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është aplikuar mbrojtja nëpërmjet temës të mikrotezës, për mbrojtjen e së cilës me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe urdhërit të Dekanit, ngrihet një komision, i cili vlerëson punën kërkimore të studentit, ecurinë e tij, dhe vlerësimin e udhëheqësit. Referuar rregullores së Institucionit[285], të Njësisë Kryesore[286], si dhe rregullores së Diplomimit[287 288], cikli i dytë i studimeve Master Shkencor përmbyllet vetëm me mbrojtjen e mikrotezës. Mbrojtja e mikrotezës bëhet para një komisioni të propozuar nga njësia bazë dhe të miratuar nga njësia kryesore. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | **Po.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave. Sipas udhëzimeve, studentët mund të kontaktojnë një profesor apo lektor si udhëheqës, në mënyrë që të mund të marrin orientimin e duhur për përcaktimin e temës së mikrotezës. Teza e mikrotezës është punim individual i studentit. Ajo nuk mund të mbrohet përpara komisionit nëse më parë nuk është dhënë miratimi me shkrim i personelit akademik udhëheqës. Studenti duhet të dorëzojë në departament punimin përfundimtar në tre kopje së bashku me miratimin e personelit akademik udhëheqës të paktën 2 javë përpara datës së shpallur për mbrojtjen e temës[289]. Në nenin 2, 5, 6-të rregullores së Diplomimit[290] janë përcaktuar detyrat kryesore të stafit akademik për orientimin dhe drejtimin e studentëve. Personeli akademik udhëheqës ruan kontakt të vazhdueshëm me studentin, e oriention dhe asiston atë gjatë zhvillimit të punimit dhe është përgjegjës për miratimin e temës së mikrotezës. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | **Po.** Institucioni mund të asistojë studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në varësi të temave dhe fushës së studimit. Të gjitha burimet si pajisje informatike ashtu si edhe biblioteka[291] janë në dispozicion të studentëve për realizimin e projekteve të tyre kërkimore shkencore. Ambjentet e Fakultetit të Biznesit, laboratorët mësimore dhe kërkimorë, biblioteka etj. janë në dispozicion të studentëve edhe jashtë orareve mësimore kur këta të fundit kërkojnë ti përdorin këto ambjente për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, |

[276] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[277] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[278] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[279] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[280] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[281] Evidenca 26: Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet
[282] Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[283] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[284] Evidenca 65: Faqet elektronike
[285] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[286] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[287] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[288] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[289] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[290] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[291] Evidenca 34: Abonim në librarinë digjitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF

| | |
|---|---|
| | zhvillimin e projekteve mësimore ose dhe projekteve kërkimore. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | **Po.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, me anë të nënshkrimit të deklaratës mbi origjinalitetin e punimit.[292] Udhëheqësi shpreh vlerësimin e tij për temën duke plotësuar formularin përkatës[293]. Tema e mikrotezës për programin *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* vlerësohet me notë bazuar në pikët e përftuara nga studenti dhe me të njëjtën shkallë vlerësimi si lëndët e tjera të këtij programi neni 68, pika 8[294]. Në përfundim të mbrojtjes së mikrotezës studenti vlerësohet me pikë nga komisioni përkatës[295]. Këto pikë konvertohen më tej në notën përfundimtare të vlerësimit të temës të mikrotezë sipas rregullores së UAMD-së për kontrollin e dijeve[296]. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | **Po.** Në bazë të nenit 91, të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë[297]. Procedurat e lëshimit të diplomës përcaktohen në rregulloret e institucionit neni 76 dhe neni 90[298]. Suplementi i diplomës përmban të gjithë elementët e programit të studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*[299]. Ky dokument ofrohet në shqip dhe në anglisht. |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | **Po.** Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale[300]. Në çdo kohë studentët dhe ish studentët e Fakultetit të Biznesit mund të kërkojnë pranë sekretarisë mësimore[301] të Fakultetit të Biznesit vërtetime të thjeshta dhe listë notash të programit të studimit që ndjekin ose kanë përfunduar.Me kërkesë të tyre ata mund të pajisen edhe me programin lëndor për çdo kurs që ata kanë zhvilluar[302 303]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.6<br>Në rastin e programit të studimit në "Master profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

[292] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit/ Aneks
[293] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit/ Aneks
[294] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[295] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit/ Aneks
[296] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[297] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[298] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[299] Evidenca 100: Modeli i diplomës Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet (Urdhëri i aprovimit)
[300] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[301] Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[302] Evidenca 52: Rregullore për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD/Vendim S.A. Nr. 141 datë 27.09.2018
[303] Evidenca 56: Udhëzim Nr. 52, datë 03.12.2015 "Për Përcaktimin e Niveleve të Gjuhëve të Huaja dhe të Testeve Ndërkombëtare, për Pranimet në Programet e Studimit të Ciklit të Dytë dhe të Tretë, në IAL"

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | NA |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | NA |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | NA |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

# IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | **Po.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë si edhe personeli ndihmës akademik ka nivelin e duhur të kualifikimit për realizimin e veprimtarive të moduleve dhe lëndëve të programit të studimit[304]. Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*, i përmbush kërkesat ligjore, të përcaktuara në Ligjin për arsimin e lartë, ligji Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" aktet nënligjore në zbatim të tij[305] dhe kriteret e shpallura nga departamenti bazuar në procedurat e rekrutimit të lektorëve me kohë të pjesëshme.<br><br>Personeli efektiv akademik dhe me kontratë zotëron tituj dhe grada në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Departamenti Financë-Kontabilitet përbëhet nga 16 anëtarë, nga të cilët një Prof.Dr., një Prof.Asc.Dr., një Doc.Dr., tetë Doktor Shkencash, pesë Doktorantë (në IAL të huaja)[306]. Fushat e studimit të anëtarëve të Departamentit janë në përputhje me modulet dhe lëndët e ofruara në programin e studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*[307 308]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | **Po.** Udhëzimi nr.29 i datës 10.09.2018 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përcakton ngarkesën mësimore të personelit akademik efektiv në IAL në bazë të kategorive të ndryshme. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* mbulon ngarkesën mësimore bazuar në kornizën ligjore në fuqi[309 310]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | **Po.** Marrëdhënia e punësimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës rregullohet nëpërmjet kontratës së punësimit[311]. Çdo muaj Drejtoria e Shërbimeve Financiare e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës i përcjell me e-mail raportimin e pagës personelit akademik ku janë të detajuara dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore[312]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe | **Po.** UAMD rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (nenet 64-67), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar si dhe |

304 Evidenca 14: CV-të e lektorëve, Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet, periudha 2018-2021
305 Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015
306 Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
307 Evidenca 19: Shkresë Nr. Prot 31 Datë 25.01.2022_Fushat kërkimore shkencore për Dep. Financë – Kontabilitet
308 Evidenca 48: Ngritja e grupeve mësimore-kërkimore Departamenti Financë-Kontabilitet.
309 Evidenca 110: Udhëzimi Nr.29, dt 10.9.2018, MAS
310 Evidenca 109: Ngarkesën Mësimore e Stafit Akademik në V.A 2019-2022
311 Evidenca 112: Model Kontrate Pune - UAMD
312 Evidenca 113: Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore për periudhën 2004-2023

| | |
|---|---|
| përmbajtjen e programit të studimit. | akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregulloren e UAMD dhe Statutin e UAMD[313 314] .<br><br>Në varësi të strukturës së miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës" , Njësia Bazë përcakton kriteret që duhet të përmbushen nga aplikanti. Këto kritere i përcillen Drejtuesit të Njësisë Kryesore, i cili pasi i miraton ia përcjell Rektorit[315].Mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga njësia bazë, shpallet konkurs i hapur "Për vendet të lira të punës për personel akademik me kohë të plotë"(ose të pjesshme) dhe kryhet publikimi në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjensisë së Prokurimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu njoftimet publikohen edhe në faqen zyrtare të UAMD[316].<br><br>E njëjta proçedurë rekrutimi ndiqet edhe në rastin e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe Rregulloren e UAMD. Kërkesat për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme përcaktohen bazuar në nevojat e Njësisë Bazë sipas programeve përkatëse të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | **Po.** Personeli ndihmës akademik i Fakultetit të Biznesit është i përbërë nga sekretaria e ciklit të dytë master, asistenti i departamentit dhe dy laborantë[317], të cilë ofrojnë mbështetje për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe laboratorike. Stafi ka kualifikimin e duhur për t'iu përshtatur nevojave dhe natyrës specifike të programit të studimit[318]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | **Po.** Çdo vit akademik personeli akademik plotëson formularët e vetvlerësimit ku pasqyrohet progresi shkencor dhe akademik mbi të cilin bëhet vlerësimi i performancës[319]. Njësia bazë dhe njësia kryesore hartojnë çdo vit analizën vjetore në të cilën pasqyrohet progresi i personelit akademik[320]. Gjithashtu Institucioni perditëson në mënyrë periodike ndryshimet e personelit ndihmës dhe administrativ në mbështetje te programit të studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.*[321] |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit kanë marrëveshje me IAL dhe organizata biznesi. Studentët kanë në dispozicion Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike që ka nën varësi Sektorin e Karrierës dhe të Alumni ku Neni 15 i rregullores së kësaj Drejtorie përcakton funksionimin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit dhe shërbimeve që ajo ofron për studentët në procesin e praktikës dhe punësimit[322]. Në rregulloren e Praktikës Mësimore përcaktohen |

[313] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[314] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[315] Evidenca 114: Procedura e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Biznesit
[316] Evidenca 115: Shkresa nr.1318/2 prot datë 22.10.2020 "Ngritja e Komisioneve ad-hoc për Rekrutimin e Personelit", FB
[317] Eidenca116: Vendimi Nr.30/2018 dhe 8/2023, Struktura analitike të punonjësve buxhetorë të UAMD
[318] Evidenca 117: CV e Stafit Ndihmës Akademik në MSH Financë-Kontabilitet
[319] Evidenca 15: Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Dep. Financë - Kontabilitet, V.A 2020-2021
[320] Evidenca 93: Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet
[321] Evidenca 117: CV e Stafit Ndihmës Akademik në MSH Financë-Kontabilitet
[322] Evidenca 111: Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

| | |
|---|---|
| së programit të studimit. | strukturat përgjegjëse të praktikës mësimore në Nenin 3 të saj dhe në Nenin 4 procesi i zhvillimit të praktikës mësimore[323]. Në rregulloren e tezës së diplomës në Nenin 2 dhe Nenin 3 përcaktohet udhëheqësi dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të diplomës[324]. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimimi me IAL të tjera, përfaqësues biznesi dhe kompani të cilat lehtësojnë zhvillimin e praktikave mësimore dhe realizimin e punimeve të diplomës. Marrëveshje bashkëpunimi janë të lidhura edhe në nivel departamenti[325 326]. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës, si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | **Po.** Neni 4 i Rregullores së Praktikës Mësimore përcakton procesin e zhvillimit të praktikës mësimore për studentët në programin e studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* [327]. Referuar rregullores së fakultetit, vendimit të Dekanit për ngritjen e komisioneve të mbrojtjes së praktikës dhe mikrotezës, lektorët udhëheqin dhe bëjnë vlerësimin përfundimtar të studentëve para komisionit të mbrojtjes së praktikës dhe mikrotezës së diplomës[328]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit**

| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.<br>Fakulteti i Biznesit e zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën Nr.2 të Kampusit Universitar, Spitallë. Në këtë godinë disponohen mjedise të mjaftueshme mësimore: 15 auditorë, 2 laboratorë, bibliotekën dhe sallën e konferencave të cilat janë të dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe studimit për të garantuar veprimtarinë mësimore të programit të studimit[329]. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | **Po.** Mjediset mësimore dhe laboratorike në Fakultetin e Biznesit, që ndodhen në godinën Nr.2 të Kampusit Universitar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, janë të pajisuara me të gjitha pajisjet e nevojshme teknologjike dhe digjitale që janë të nevojshme për procesin e mësim-dhënies dhe mësim- nxënies. Auditorët janë të pajisura me tabela whiteboard dhe mundësi për videoprojektor të lëvizshëm të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore.<br>Zyrat e personelit akademik dhe administrativ që gjenden në këtë godinë, janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kompjuter, printer, tavolinë pune, dollap etj). Laboratorët janë të përshtatshëm për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe përmbajnë |

323 Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
324 Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
325 Evidenca 23: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve
326 Evidenca 22: Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet UAMD dhe Partnerëve
327 Evidenca 41: Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
328 Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
329 Evidenca 117: Infrastruktura

| | |
|---|---|
| | aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve[330]. |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | **Po.** Laboratorët e Fakultetit të Biznesit plotësojnë nevojat e studentëve të programit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* duke i ofruar pajisjet e duhura teknologjike dhe digjitale në mënyrë që të plotësohen nevojat e tyre për studim dhe kërkim shkencor. Dy laboratorët që janë në funksion të Fakultetit të Biznesit kanë gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 $m^2$. Laboratorët janë të pajisur me programe standarte por edhe specifike si Financa 5, eviews,të cilat plotësojnë nevojat e studentëve për studim dhe kërkim shkencor[331]. Në vitin akademik 2021-2022 është shtuar laboratori për ciklin e dytë dhe tretë të studimeve, i cili krahas programeve të mësipërme ka dhe softwerët si SPSS/programin antiplagjiaturë Grammarly etj[332]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | **Po.** Institucioni me kapacitetet që zotëron garanton infrastrukturën e mjaftueshme për zhvillimin e praktikave laboratorike. Së fundmi, në godinën e re të fakultetit të Biznesit, në kampusin e ri universitar është ndërtuar laboratori i ri i pajisur me të gjitha kompjuterat dhe mjetet e duhura për studentët, për të realizuar proçesin mësimor për lëndë specifike të profilit të tyre. Laboratori është bërë i mundur nga bashkëpunimi i Fakultetit të Biznesit me qendrën Crystal Center. Gjithashtu në të gjithë kompjuterat e këtij laboratori do të instalohet programi Financa 5, i cili duhet të njihet nga çdo ekonomist i ardhshëm[333]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | **N/A** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme)** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e | **Po.** Në çdo fillim semestri studentët e programit të studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*, njihen me literaturën bazë dhe ndihmëse të kërkuar për realizimin me sukses të procesit mësimor, sikurse është parashikuar në syllabuset e lëndëve. Kjo literaturë eshte vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit nga personeli |

330 Evidenca 118: Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB
331 Evidenca 118: Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB
332 Evidenca 119: Raporti Per Laboratorin e Doktoratures 12.10.2022
333 Evidenca 117: Infrastruktura

| | |
|---|---|
| studimit. | akademik duke garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit[334].<br>Biblioteka Shkencore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës siguron literaturën bazë dhe ndihmëse nëpërmjet ofrimit të sallës me fond të hapur me literaturë referenciale, periodike, literaturë prej burimeve elektronike të bibliotekës, literaturë me burime elektronike të huaja.Literatura e vënë në dispozicionin e studentëve mbëtështet nevojat e tyre mësimore dhe të kërkimit shkencor. Biblioteka disponon gjithashtu edhe një fond të mbyllur. 80% e literaturës së vënë në dispozicion është e 10 viteve të fundit dhe nga shtëpitë botuese të mirënjohura ndërkombëtarisht. Mbështetur në nenin 38 të Rregullores së Shërbimeve Akademike,[335] studentët nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) kanë akses në platformën U-Albania. Literatura bazë është e mbledhur edhe në listën e titujve në Bibliotekë për programin e studimit[336] [337]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | **Po.** Njësia bazë raporton raporton rregullisht nevojat për pasurimin e koleksioneve fizike dhe digjitale të bibliotekës me botimet e viteve të fundit të literaturës bazë dhe të rekomanduar të lëndëve të kurrikulës së programit të studimit. Përgjegjësi i njësisë bazë transmeton të dhënat përmbledhëse të mbledhura nga personeli akademik mbi literaturën bazë dhe të rekomanduar, të lëndëve dhe moduleve të ndryshme. Syllabuset e lëndëve përditësohen vazhdimisht me botime të viteve të fundit,që të garantohet cilësia e mësimdhënies[338]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | **Po.** UAMD vë në dispozion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën mësimore e cila mundëson jo vetëm ambiente studimi, por edhe ambiente sociale, si edhe ambiente, të cilat mund të shfrytëzohen nga studentë dhe kërkues për promovimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndryshme kërkuese si edhe garanton ofrimin e shërbimeve për një akses të hapur. Sipas nenit 32 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike përdorues i bibliotekës është personi juridik ose fizik që paraqet një kërkesë me shkrim ose jo për të përfituar falas ose sipas tarifave të miraturara një shërbim që ofrohet nga Biblioteka e UAMD[339]. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | **Po.** Në nenin 39 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike, Biblioteka e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës" speficikohet në salla me fond të hapur dhe me fond të mbyllur. Salla me fond të hapur ofron literaturë referenciale, periodike, literaturë print, literaturë prej burimeve elektronike të Bibliotekes, literaturë prej burimeve elektronike të huaja dhe akses në Internet. Ndërsa salla me fond të mbyllur ofron Literaturë në gjuhë të huaj, revista[340], gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivën akademike, arshivën digjitale. Insitutcioni vë në dispozicion gjithashtu edhe Listën e Paketave që përfshihen në U-LIBRARY dhe j-stor.org[341] [342]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës garanton akses të plotë pa pagesë në paketën U-LIBRARY për të gjithë studentët si dhe j-stor.org në të cilat ka një shumëllojshmëri literature për studentët e programit të studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*. Në dispozicion të studentëve janë edhe sistemi KOHA dhe COBISS+. Studentët kanë |

[334] Evidenca 53: Syllabuset e *Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.* 2021-2022//Sem.3
[335] Evidenca 111: Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[336] Evidenca 120: Propozim blerje librash
[337] Evidenca 121: Digital Library - Universiteti Aleksandër Moisiu
[338] Evidenca 122: Të dhëna për Bibliotekën
[339] Evidenca 111: Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[340] Evidenca 111: Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[341] Evidenca 34: Abonim në librarinë digjitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF JStore
[342] Evidenca 123: Të dhëna për platformën Online

| | |
|---|---|
| | gjithashtu në dispozicion edhe një manual të përdorimit të Bibliotekës online[343] [344].<br>Sistemi "KOHA" është një databazë e krijuar nga biblioteka e UAMD-së dhe ndihmon përdoruesit të shkarkojnë libra, artikuj shkencor, desertacione, etj, pa limit kohor përdorimi.<br>COBISS+ është krijuar për të gjithë përdoruesit: kërkuesit shkencorë, nxënësit, studentët, prindërit, profesorët, pensionistët, etj, për të gjithë ata, që kërkojnë informacione dhe materiale (edhe ato elektronike), të cilat janë në dispozicion në bibliotekat e Shqipërisë. Me iniciativën e vet Departamenti i Financë-Kontabilitetit aktualisht është periudhë testimi për një marrëveshje bashkëpunimi për aksesin pa pagesë në platformën universitare "Coursera", e cila mundëson 4000 kurse ndërkombëtare online, mbi 200 universitete të huaja partnere, 71 milion përdorues, 500 kompani prestigjoze ndërkombëtare dhe shumë qeveri në mbarë botën[345]. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | **Po.** Salla me fond të hapur ofron të gjitha facilitetet digjitale në formën hardware apo software për të lehtësuar veprimtarinë kërkuese dhe studimore të të gjithë studentëve të programit të studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet*, e cituar kjo edhe në neni 39 të Rregullores së Drejtorisë së Administrimit të Shërbimeve Akademike[346]. Gjithashtu biblioteka bën dhe rinovimin e licencave të programeve kompjuterike të kompiuterave që disponojnë[347]. |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | **Po.** Oraret e shërbimit të Bibliotekës janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Biblioteka ka orare të përshtatshme me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. Biblioteka në universitetin tonë qëndron e hapur edhe në fundjavë për ti shërbyer sa më mirë kryesisht studentëve të programeve master që zhvillojnë leksione dhe kërkime shkencore në fundjavë[348] [349]. Koleksioni përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standarteve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU, Orari i shërbimit të përdoruesve e hënë- e premte: 8:00- 16:00 dhe Shërbimi i informacionit elektronik e hënë- e diel: 8:00-20:00 për të aksesuar shërbimin e libraries digjitale. Fillimisht aksesohet në linkun: https://ulibrary.rash.al/ dhe Faqja kryesore e shërbimit përmban krahas një videoje informuese dhe hapat kryesore që duhet të ndiqen . |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit *online* (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit *online* nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij *online*, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | **Po.** Njësia bazë Departamenti i Financë-Kontabilitetit përgjegjëse për programin e studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* ndjek dhe raporton nevojat për fondin fizik dhe fondin online të programit të studimit në bashkëpunim me bibliotekën në mënyrë që të përmbushen nevojat e studentëve të programit të studimit. Zhvillimi dhe vlerësimi i pasurisë akadermike,kulturore dhe shkencore realizohet nërmjet politikave në nivel universitar duke evidentuar numrin e frekuentuesve në bibliotekë, frekuencës së përdorimit të titujve, cilësinë e revistave ku botojnë artikujt shkencor stafi akademik,etj. Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literatures shkencore. |

[343] Evidenca 124: Manual Biblioteka Online
[344] Evidenca 123: Të dhëna për platformën Online
[345] https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2021/07/05/ndiq-një-kurs-falas-ne-coursera-dhe-zhvillo-karrieren-tende/
[346] Evidenca 111: Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[347] Evidenca 125: Rinovimi i licencave të Microsoft për bibliotekën
[348] Evidenca 130: Rregullore e Bibliotekës
[349] Evidenca 126:Vendimi i funksionimit të bibliotekës edhe në fundjavë

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit *nëpërmjet* të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | **Po.** Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve Akademike neni 30 [350], sekretaria e Fakultetit të Biznesit[351] dhe Njësia Bazë përgjegjëse[352] për programin e studimit disponojnë një sistem të menaxhimit të informacionit të studenteve në hyrje dhe në dalje. Pjesa më e rëndësishme e sistemit të menaxhimit të informacionit në lidhje me studentët përbëhet nga Sekretaritë mësimore në çdo fakultet dhe sistemi elektronik Pitagora (RASH-i). Funksionet e Sekretarisë mësimore për Fakultetin e Biznesit janë të përcaktuara në rregulloren e Fakultetit të Biznesit[353], dhe rregulloren e Sekretarisë Mësimore[354] .<br><br>Sekretaria mësimore administron të gjithë informacionin që lidhet me të dhëna të detajuara për studentët që regjistrohen mbështetur në nenin 27, pika 1 dhe 2 të Rregullores së Sekretarisë mësimore. Ndjekja e informacioneve në lidhje me studentët bëhet që në momentin e regjistrimit në regjistrin bazë dhe në regjistrin e arritjeve akademike sipas neneve 76-80 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[355], deri në momentin e diplomimit të tyre. Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit ka në dispozicion të studentëve sistemin Pitagora në të cilën studentët aksesojnë infomacione të ndryshme përgjatë kohës së studimit. Ky sistem aplikohet për studentët e ciklit të parë dhe dytë të studimeve[356]. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, *personelit* ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | **Po.** Njësia bazë si edhe struktura e Burimeve njerëzore menaxhojnë dhe administrojnë dokumentacionin për personelin dhe partnerët e anganzhuar në programin e cikilit të dytë të studimeve. Në kriterin 2 të sistemit elektronik, specifikohet se disponohet dokumentacioni i nevojshëm me informacionet mbi stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe për stafin administrativ. Sektori i Burimeve Njerëzore disponon dosjet e të gjithë stafit akademik dhe administrativ që prej aplikimit të tyre[357]. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente *për* të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | **Po.** UAMD ka implementuar një sistem të menaxhimit të integruar të studentëve që nga viti 2010. Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit disponojnë për secilin semestër të vitit akademik listën e plotë të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit sipas orareve të miratuar[358]. Platforma Pitagora mundëson transmetimin e vlerësimit të dijeve të studentëve nga pedagogu te studenti në konfidencialitet dhe transparencë të plotë[359]. |

[350] Evidenca 111: Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[351] Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[352] Evidenca 26: Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet
[353] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[354] Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[355] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[356] Evidenca 70: Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE/PITAGORA (RASH)
[357] Evidenca 127:Rregullore e Burimeve Njerëzore dhe Juridike
[358] Evidenca 40: Orari Mësimor Semestral V.A 2021-2022
[359] Evidenca 70: Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE/PITAGORA (RASH)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë *forma* të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | **Po.** Referuar situatës së COVID-19 në funksion të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, Departamenti Financë-Kontabilitetit krahas kontaktit fizik me studentët kryesisht nëpërmjet sekretarisë mësimore, ka realizuar dhe mësimin online me mbështjetjen e platformave elektronike të certifikuara[360]. Sistemi Pitagora është një prej sistemeve teknologjike e cila mundëson komunikimin ndërmjet studentëve dhe lektorëve. Në këtë platformë, studentët kanë një llogari personale e cila aksesohet tek "zona e studentit". |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime *individuale* dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | **Po.** Njësia kryesore ka ngritur struktura të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Në kriterit 5 të sistemit elektronik speficikohet sesi garantohet monitorimi në kohë reale[361]. Sistemi i menaxhimit të informacionit nuk ekziston i plotë në formë elektronike, por vetëm në hard-copy.E gjitha veprimtaria akademike dhe administrative wshtw e rregulluar dhe monitorohet sipas neneve 38, 39, 51-55 dhe neni 56 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[362]. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e *ndryshme*, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | **Po.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitete të ndryshme apo njoftime janë të disponueshme në faqen e internetitwww.uamd.edu.al në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze[363]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | **Po.** Të dhënat mbi kostot e programeve të studimit specifikojnë kostot e programit të studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* duke u mbështetur në numrin e kuotave të studentëve spefikojnë kostot e programeve të studimit në ciklin e dytë të studimeve në Fakultetin e Biznesit[364]. Programi për mbështetjen financiare hartohet nga Drejtoria e financës dhe buxhetit në UAMD I cili përllogarit koston e mbulimit të një cikli të plotë studimi. Të dhënat progresive të UAMD për periudhën Janar 2019-Prill 2022 tregojnë realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara në krahasim me ato faktike, ku tregohet qëndrueshmëria financiare e insititutionit për mbështjetjen financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit[365]. |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për | **Po.** Departamenti i Financë-Kontabilitetit duke qënë njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka hartuar një plan financimi ku specifiksohen kërkesat për financim që përfshijnë:shpenzime si materiale për zyrë, shpenzime specifike që përfishijnë literaturën fizike dhe online, aksesin në teknologji, shërbime të ndryshme që financojnë burimet |

[360] Evidenca 70: Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE/PITAGORA (RASH)
[361] Evidenca 70: Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE/PITAGORA (RASH)
[362] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[363] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[364] Evidenca 8: Dosja për hapjen e programit MSc Financë-Kontabilitet: Datë 25 / 05 /2018
[365] Evidenca 131: Raport Financiar për Shpenzimet dhe të Ardhurat e Realizuara për Vitin Akademik 2021-2022

| | |
|---|---|
| mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat *online*, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | njerëzore si ato për udhëtim, shpenzime të zakonshme për mirëmbajtjen e godinave e mjediseve për mësimdhënie si edhe shpenzime të tjera operative që facilitojnë jo vetëm procesin mësimor por edhe aktivitete të ndryshmë[366]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | **Po.** Auditimi i brendshëm në UAMD kryhet sipas udhëzimit për Auditin e Brendshëm në përputhje me proçedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik" dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm.<br>Auditimi i brendshëm në UAMD kryhet në mënyrë të pavarur dhe ofron këshillim për menaxhimin financiar me qëllimin e përmirësimit të veprimtarisë së UAMD-së. Karta e Auditit e UAMD-së miratohet nga Bordi i Administrimit dhe përfshin qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë, përgjegjësitë dhe organizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në UAMD. |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | **Po.** Institucioni garanton transparencën e raportimit të të dhënave progresive pranë njësisë përgjegjëse Departamenti i Financë-Kontabilitetit përgjegjëse për programin e studimit *Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet* për realizmin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës[367]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | **Po.** Raporti i të dhënave progresive tregon qëndrueshmërinë financiare të institucionit për zhvillimin e programit të studimit të njësisë bazë[368]. Institucioni mbështet financiarisht edhe studentët në nevojë si edhe kërkimin shkencor[369] [370]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

366 Evidenca 129: Projektbuxheti i Departamentit të Financë-Kontabilitetit
367 Evidenca 131: Raport Financiar për Shpenzimet dhe të Ardhurat e Realizuara për Vitin Akademik 2021-2022
368 Evidenca 131: Raport Financiar për Shpenzimet dhe të Ardhurat e Realizuara për Vitin Akademik 2021-2022
369 Evidenca 63: Shpallja e Njoftimit "Kriteret dhe Procedurat e Aplikimit për Bursë Studenti, V.A. 2021-2022"
370 Evidenca 131: Raport Financiar për Shpenzimet dhe të Ardhurat e Realizuara për Vitin Akademik 2021-2022

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | **Po.** *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* organizohet në mbështetje të ligjit për arsimin e lartë në Shqipëri dhe akteve rregullatore institucionale. Politika dhe procedurat që mbulojnë këtë cikël studimi garantojnë ndjekjen e studentit nga hyrja deri në diplomimin/daljen e tij[371] [372] [373] [374] [375]. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | **Po.** Politikat dhe procedurat, nga hyrja në dalje e studentëve, janë të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore institucionale. *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* udhëhiqet nga parimi i barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët që në aplikim dhe përzgjedhje; zhvillimin e programit dhe aktivitetet e tjera ekstra-kurrikulare; dhe daljen e tyre[376] [377] [378] [379] [380] [381] [382]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | **Po.** Kriteret për përzgjedhje në *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* diskutohen dhe propozohen nga njësia bazë përpara çdo viti akademik, në mbledhje të posaçme. Propozimi i kritereve bëhet duke respektuar të gjithë legjislacionin në fuqi. Drejtuesi i njësisë bazë dorëzon vendimin e departamentin për kriteret e propozuara tek njësia kryesore e cila ja përcjell drejtimit të IAL-së[383] [384]. Kriteret publikohen në faqen zyrtare të institucionit[385]. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | **Po.** Informimi i studentëve dhe palëve të interesuara është i rregulluar sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve tjera institucionale[386] [387] [388] [389] [390] [391] [392]. Publiku mund të informohet për gjithçka i përket *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* në faqen zyrtare të UAMD-së dhe në faqe të ndryshme sociale të menaxhuara nga stafi i UAMD-së, aktivitete, broshurave informuese, sekretarisë mësimore, stafit akademik, etj[393] [394] [395] [396]. |

[371] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015
[372] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[373] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[374] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[375] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[376] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015
[377] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[378] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[379] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[380] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[381] Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
[382] Evidenca 68: Panairi i Punës dhe Karrierës, V.A. 2020-2021
[383] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015
[384] Evidenca 56: Udhëzim Nr. 52, datë 03.12.2015 "Për Përcaktimin e Niveleve të Gjuhëve të Huaja dhe të Testeve Ndërkombëtare, për Pranimet në Programet e Studimit të Ciklit të Dytë dhe të Tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë"
[385] Evidenca 59: Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kritereve të Pranimit për Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2020-2021
[386] Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
[387] Evidenca 1: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015
[388] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[389] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[390] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[391] Evidenca 26: Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet
[392] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[393] Evidenca 64: Guida e Studentit, V. A. 2020-2021

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | **Po.** Institucioni respekton të drejtën e informimit për të gjithë palët e interesuara rreth kritereve dhe kërkesave të përgjithshme e të veçanta të *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*. Kriteret shpallen në faqen zyrtare dhe brenda ambienteve (në hapësira të dedikuara) të IAL-së. I gjithë kalendari për aplikimin dhe përzgjedhjen e studentëve rregullohet sipas udhëzimeve të MASR-së dhe u komunikohet aplikantëve në fazën e aplikimit përmes sekretarisë mësimore dhe shpalljeve brenda ambienteve të IAL-së[397] [398] [399] [400] [401]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | **Po.** Në kuotat e pranimit parashikohen edhe kuota për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare, me status jetimi si dhe personat me aftësi të veçanta. *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* nuk përjashton mundësinë e integrimit e shtresave më vulnerabël të shoqërisë[402]. |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | **Po.** Në kuotat e pranimit parashikohen edhe kuota për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare, me status jetim si dhe personat me aftësi të veçanta. *Programi Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ofron 1 kuotë për ndjekjen e studimeve për kandidatë Kosova[403]. |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | **Po.** Institucioni në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe akteve tjera institucionale harton dhe bën publike, në faqen zyrtare dhe mjediset e dedikuara brenda IAL-së, politikat e ndihmës/bursave sipas kategorive përfituese[404] [405] [406] [407]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | *Përmbushet plotësisht* |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

[394] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[395] Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[396] Evidenca 67: Email Orientues rreth Praktikës dhe Mikrotezës_Lektori Udhëheqës, Dr. Armela Anamali
[397] Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
[398] Evidenca 59: Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kritereve të Pranimit për Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2023-2024
[399] Evidenca 59: Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kritereve të Pranimit për Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2023-2024
[400] Evidenca 55: Udhëzim Nr. 10, datë 15.5.2019 "Për Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë" (Ndryshuar me Udhëzimin nr. 17, datë 30.7.2019; nr. 19, datë 10.9.2019, nr. 15, datë 26.5.2020, nr. 17, datë 23.6.2020, nr. 25, datë 1.12.2020; nr. 11, datë 2.6.2021)
[401] Evidenca 61: Urdhër i Përbashkët "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve,..., e ciklit të dytë të studimeve në IAL për V.A. 2020-2021
[402] Evidenca 69: Vendimi i Senatit Akademik Nr. 36, datë 20.04.2021, Miratimi i Kuotave të Pranimit të Studentëve V.A. 2021-2022.
[403] Evidenca 69: Vendimi i Senatit Akademik Nr. 36, datë 20.04.2021, Miratimi i Kuotave të Pranimit të Studentëve V.A. 2021-2022.
[404] Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
[405] Evidenca 62: VKM Nr. 603 datë 21.12.2019 (ndryshuar me VKM Nr. 39 datë 23.01.2019) Për Përcaktimin e Kritereve për Përfitimin e Bursave nga Fondi i Mbështetjes Studentore, sipas Kategorive Përfituese
[406] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[407] Evidenca 63: Shpallja e Njoftimit "Kriteret dhe Procedurat e Aplikimit për Bursë Studenti, V.A. 2021-2022"

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | **Po.** Një informacioni i detajuar për kriteret dhe procedurat përparimit akademik në *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* ofrohet nga faqja zyrtare e UAMD-së, përgjegjësi i njësisë bazë, kordinatori i programit dhe sekretaria mësimore[408] [409] [410]. Në vitet e fundit studentët kanë mundësinë të informohen për progresin e tyre në *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* përmes platformës Pitagora[411], e cila ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundor (studentëve, pedagogëve, etj) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | **Po.** Kriteret për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme janë të rregulluara sipas akteve institucionale mbështetur në legjislacionin në fuqi. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm dhe i qartë për studentët. Informimi për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe studimeve të pjesshme në *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* mund të sigurohet drejtpërdrejt ose me kërkesë të interesuarit njësive përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e programit[412] [413] [414] [415] [416]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | **Po.** Informacioni lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studenteve në *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është i paraqitur në syllabuset e çdo kursi dhe u prezantohet studentëve nga stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e kursit. Informimi dhe transparenca e vlerësimit është e rregulluar nga legjislacioni në fuqi dhe akte të tjera rregullatore të institucionit[417][418] [419] [420] [421] [422] [423]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | **Po.** Kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës/mikrotezës dhe diplomimin në *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* u komunikohet studentëve përmes një sërë aktivitetesh dhe njoftimësh të koordinuara dhe në vazhdimësi ndërmjet përgjegjësit të njësisë kryesore, koordinatorit të programit, stafit akademik në udhëheqje, stafit akademik ndihmës (sekretarisë mësimore) dhe studentëvë. Studentët informohen për përgatitjen e punimit të diplomës, si pjesë e detyrimeve përmbyllëse të programit, që në hyrje dhe në vazhdimësi përmes informacionit të dhënë në faqen zyrtare të UAMD-së, postimeve në rrjetet sociale të administruara dhe mjediset e brendshme të dedikuara nga personel i brendshëm akademik dhe ndihmës akademik[424] [425] [426] [427] [428] [429]. |

[408] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[409] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[410] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[411] Evidenca 70: Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH)
[412] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[413] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[414] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[415] Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
[416] Evidenca 59: Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kritereve të Pranimit për Programin Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2020-2021
[417] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 (ndryshuar me VKM Nr. 879 datë 18.12.2019, VKM Nr. 185 datë 25.03.2021)
[418] Evidenca 53: Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A.2021-2022//Sem.3
[419] Evidenca 71: Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit
[420] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[421] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[422] Evidenca 26: Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet
[423] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[424] Evidenca 42: Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave/Fakulteti i Biznesit
[425] Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[426] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[427] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | **Po.** Njësia Bazë përgjegjëse e programit të studimit punon në fillim të çdo viti intensivisht për tërheqjen e kandidatëve potencialë për student duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura ku i shpalosen informacione në lidhje me programin e studimit, mundësitë e punësimit si edhe aftësimin e vazhdueshëm të studentëve duke qenë të hapur ndaj feedback, diskutimeve apo sugjerimeve të mundshme [430]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | **Po.** Në fillim të çdo viti akademik, Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit organizon një takim informues dhe orientues me studentët ku prezantohen të gjitha elementet e programit të studimit, planin mësimor, kohëzgjatjen e programit, strukturën e institucionit etj. Një informacion sqarues i përgjithshëm dhe i hollësishëm për *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* paraqitet edhe në faqen zyrtare të institucionit dhe platfomat elektronike sociale (të administruara nga stafi i brendshëm), përmes hapësirës apo informacionit të dedikuar studentit[431]. E drejta e informimit për organizimin dhe elementët e programit është e rregulluar sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve tjera institucionale[432] [433] [434] [435]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | **Po.** Studentët marrin informacion dhe dokumentacione/udhëzime të posaçme për lëndët/lëndët modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese për *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* që në hyrje dhe në vazhdimësi. Informacioni, mbi kurrikulën e programit dhe zhvillimin e tij, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të lëndëve/moduleve, ofrohet për studentët në formë shkresore ose elektronike nga UAMD, Fakulteti i Biznesit, Departamenti Financë-Kontabilitet dhe stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e programit[436]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | **Po.** Lidhja e studentit me tregun e punës është një ndër objektivat kryesore të këtij 5-vjeçari[437] [438]. Në ndihmë të zhvillimit të karrierës së studentëve dhe integrimin e tyre sa më të shpejtë dhe sa më afër karakteristikave formuese të *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"*, UAMD dhe njësitë përbërë të tij ofrojnë informacion të vazhdueshëm për |

[428] Evidenca 72: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet "Drejt një rruge që sa ka nisur..., praktika dhe kërkimi, roli tyre në rritjen profesionale"
[429] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[430] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[431] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[432] Evidenca 1: Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[433] Evidenca 37: VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 (ndryshuar me VKM Nr. 879 dt18.12.2019, VKM Nr. 185 dt 25.03.2021)
[434] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[435] Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
[436] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[437] Evidenca 6: Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025
[438] Evidenca 76: Rregullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Karrierës dhe Alumnit

| | |
|---|---|
| | mundësi punësimi dhe zhvillim të karrierës, zhvillojnë aktivitete dhe takime me palët e interesit në sektorin publik dhe privat[439 440 441 442 443 444]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | **Po.** UAMD dhe njësitë përbërë disponojnë kapacitete dhe logjistikë të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mesimor, informacion i cili është transparent dhe i aksesueshëm për të gjithë studentët apo palët e interesuara[445 446]. |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | **Po.** Për *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet* informacioni i brendshëm menaxhohet përmes aplikacionit Pitagora, i cila ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë së universitetit dhe përdoruesit fundor (studentëve, pedagogëve, etj) në menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. Studentët marrin orientime për regjistrimi dhe përdorimin pranë sekretarisë mësimore ose faqen zyrtare apo faqe tjera sociale të administruara nga stafi i UAMD-së[447 448]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | **Po.** Menaxhimi i informacionit për statistikat vjetore të studentëve në *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* është i rregulluar konform legjislacionit në fuqi dhe akteve tjera rregullatore të institucionit të cilat u vendosen në dispozicion personave të autorizuar sipas kërkesës[449 450 451 452 453 454 455]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika | **Po.** Menaxhimi i të dhënave statistikore për studentët është i rregulluar |

439 Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
440 Evidenca 76: Rregullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Karrierës dhe Alumnit
441 Evidenca 68: Panairi i Punës dhe Karrierës, V.A. 2020-2021
442 Evidenca 78: Plani i Veprimtarive Strategjike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2021-2023
443 Evidenca 79: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_WB6 CSOs for youth Employment Support
444 Evidenca 80: Njoftime/Aktivitete: Fakultetin e Biznesi_Organizimi i Panairit të Punës dhe Karrierës në Fakultetin e Biznesit 2022
445 Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
446 Evidenca 64: Guida e Studentit, V. A. 2020-2021
447 Evidenca 70: Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH)
448 Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
449 Evidenca 52: Rregullore për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD/Vendim S.A. Nr. 141 datë 27.09.2018
450 Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
451 Evidenca 76: Regullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Komunikimit Alumnit dhe Karrierës
452 Evidenca 81: Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit
453 Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
454 Evidenca 81: Korrespondenca elektronike e Koordinatorit të Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet dhe Specialiste Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës
455 Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet

| | |
|---|---|
| vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve tjera rregullatore në nene të dedikuara[456] [457]. Të dhënat lidhur me regjistrimet, tërheqjet, largimet para përfundimit, apo mospërfundimi me sukses i vitit akademik për *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* regjistrohen dhe ruhen pranë sekretarisë mësimore, e cila mbi bazën e një protokolli i përcjell në drejtori/institucione të tjera[458] [459] [460]. |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | **Po.** Të gjitha të dhënat për ecurinë e studentëve në *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* mbahen në regjistrat përkatës (tradicionalë) dhe regjistra elektronik (excel.doc) pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Biznesit. Lektori gjatë zhvillimit të kursit dorëzon pranë sekretarisë mësimore dy procesverbale të cilët tregojnë vlerësimin e ndërmjetëm (në pikë) dhe të plotë të kursit (në totalin e pikëve dhe me notë)[461]. Në të njëjtën kohë të dhënat janë të hedhura dhe në aplikacionin (mbështetës) Pitagora i cili menaxhohet nga persona të autorizuar[462]. Sistemi i brendshëm i informacionit për të dhënat e studentëve është i rregulluar përmes akteve institucionale. Pikënisja e sistemit është sekretaria mësimore, prej nga shpërndahet informacioni sipas një protokolli apo me kërkesë personave të autorizuar. Informacioni dhe shfrytëzimi i tij duhet të bëhet duke respektuar të dhënat konfidenciale[463]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | **Po.** Mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe aktet institucionale, UAMD kontrollon në mënyre periodike në nivel fakulteti dhe universiteti të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse. Kontrolli realizohet në nivel njësie kryesore nga një grup i ngritur brenda Fakultetit Biznesit dhe nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm[464] [465] [466] [467]. |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | **Po.** Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e *Programit Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* deri më tani ka diplomuar dy brezat e parë. Megjithë vështirësive me të cilat njësia bazë është përballur në zhvillimin e programit (si pasojë e tërmetit në Nëntor 2019, me epiqendër qytetin e Durrësit dhe Covid-19), ka arritur që falë angazhimit, përkushtimit dhe punës serioze të stafit e në veçanti studentëve, të diplomojë individ të kualifikuar dhe të denjë për shoqërinë. Për realizimin e analizës periodike së programit njësia bazë mbështetet në aktet institucionale, në bashkëpunimin e bredshëm dhe me palët e treta[468] [469] [470] [471] [472] [473] [474]. |

[456] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[457] Evidenca 20: Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[458] Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[459] Evidenca 76: Regullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Komunikimit Alumnit dhe Karrierës
[460] Evidenca 81: Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit
[461] Evidenca 71: Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit
[462] Evidenca 83: Ligji Nr.9887, datë 10.3.2008, Për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale
[463] Evidenca 52: Rregullore për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD/Vendim S.A. Nr. 141 datë 27.09.2018
[464] Evidenca 1: Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
[465] Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
[466] Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
[467] Evidenca 89: Raport Kontrolli Sekretaria Mësimore, Fakulteti i Biznesit V.A. 2019
[468] Evidenca 21: Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[469] Evidenca 26: Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet
[470] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD
[471] Evidenca 66: Rregullore e Sekretarisë Mësimore
[472] Evidenca 76: Regullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Komunikimit Alumnit dhe Karrierës
[473] Evidenca 51: Statistika/ Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet
[474] Evidenca 84: Plani Strategjik i Dep. Financë – Kontabilitet, 2021-2025

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | **Po.** Institucioni parashikon përfaqësimin e studentëve në organet e UAMD, dhe përfshirjen në vendimmarrje dhe veprimtari këshilluese, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet tjera institucionale[475 476 477 478 479]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | **Po.** UAMD garanton që e drejta e studentit për përfshirje në vendimarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik të jetë transaparente dhe të kontribojë në përmirësime të mëtejshme[480 481 482]. Studenti është aseti kryesor dhe UAMD mban përgjegjësinë që zëri i studentit të dëgjohet. Institucioni dhe njësitë përbërëse të tij në mënyrë periodike, por jo vetëm, përdorin instrumenta të ndryshëm ku studenti të konkretizojë të drejtat e tij/saj[483 484 485]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi etj. | **Po.** Dep. Financë-Kontabilitet përmes stafit akademik, përgjegjësit dhe koordinatorit merr në konsideratë për shqyrtim të gjithë sugjerimet e studentëve për *Programin Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet.* Përveç kohës së dedikuar fashës **Diskutime Staf-Studentë-I/Të Ftuar** në aktivitetet e ndryshme dhe instrumentit pyetsor, departamenti jep mundësinë që studentët të jenë të lirë të japin mendimin dhe sugjerimet e tyre në faqen sociale të Departamentit Financë-Kontabilitet[486 487 488]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të | **Po.** Studenti gëzon të drejtën e dhënies së mendimit mbi procesin kontrollit të dijeve, e rregulluar nga legjislacioni në fuqi dhe aktet institucionale[489 490 491 492 493]. Studenti përmes mekanizmave të ndryshëm elektronike apo |

475 Evidenca 1: Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015
476 Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
477 Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
478 Evidenca 20: Regullore e Fakultetetit të Biznesit
479 Evidenca 85: Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje/Këshillim/Vlerësim,UAMD
480 Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
481 Evidenca 20: Regullore e Fakultetetit të Biznesit
482 Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
483 Evidenca 85: Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje/Këshillim/Vlerësim,UAMD
484 Evidenca 86: Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje/Këshillim/Vlerësim vlerësimin mbi Procesin Akademik, UAMD
485 Evidenca 72: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_ "Drejt një rruge që sa ka nisur..., praktika dhe kërkimi, roli tyre në rritjen profesionale"
486 Evidenca 86: Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje/Këshillim/Vlerësim mbi Procesin Akademik, UAMD
487 Evidenca 87: Njoftime/Aktivitete: Dep. Financë – Kontabilitet_Kalendari i Aktiviteteve Shkencore, Kulturore , Sociale etj.V.A. 2020-2021, 2021-2022
488 Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
489 Evidenca 2: Statuti i UAMD-së
490 Evidenca 25: Rregullore e UAMD-së
491 Evidenca 20: Regullore e Fakultetetit të Biznesit
492 Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
493 Evidenca 71: Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | shkresore mund të shpreh mendimin e tij për trajtimin dhe vlerësimin e marrë nga pedagogu përgjegjës[494]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | **Po.** UAMD-ja karakterizohet nga afërsia me studentin dhe mbështetja e tij/saj me informacion për çdo nevojë apo kërkesë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore institucionale[495] [496]. I gjithë informacioni i nevojshëm është lehtësisht i aksesueshëm përmes faqeve elektronike të IAL-së, njësive përbërëse të saj dhe njësive të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve (Sektori i Alumnit_Karrierës, Sekretari Mësimore, Departamenti Financë-Kontabilitet dhe Koordinatori i Programit). |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | **Po.** UAMD në vitin akademik 2021-2022 ka integruar si pjesë të infrastrukturës mbështetëse të procesit mësimor sistemin Pitagora, ku studentët regjistrohen në kurset semestrale dhe marrin njoftime mbi vlerwsimin e vazhduar. Në informimin e studentëve për programin *Master i Shkencave "Financë-Kontabilitet"* janë të angazhuar kordinatori i programit, përgjegjësi i departamentit, sekretaria mësimore dhe zyra e karrierës. Ndërkohë të gjitha njoftimet e nevojshme u komunikohen studentëve si nga lektorët përkatës në kurset që ato zhvillojnë edhe në faqet elektronike të institucionit[497]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | **Po.** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit[498] dhe Alumni Network FB[499]. Institucioni bën informim të vazhdueshëm të studentëve, organizon aktivitete të ndryshme me partnerët e FB për bashkëpunim me biznesin për orientimin e praktikës profesionale.<br>Gjithashtu dhe njësia bazë ndihmon në orientimin e studentëve drejt këtyre zyrave duke shfrytëzuar marrëveshjet e bashkëpunimit me FB (komunikim me studentët për pozione pune në institucione financiare). |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në | **Po.** Zyra/njësia e karrierës pranë UAMD në bashkëpunim me Alumni Network FB mbajnë dhe përpunojnë të dhëna për studentët e diplomuar (lista bashkëngjitur te Alumni Network FB)[500]. Alumni Network FB shpërndan një pyetësor për gjurmimin e studentëve pas diplomimit të tyre[501]. |

[494] Evidenca 88: Pyetsori i Studentit, si e drejtë e shprehjes se mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit
[495] Evidenca 64: Guida e Studentit, V. A. 2020-2021
[496] Evidenca 60: Programi i Transparencës, UAMD
[497] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[498] Evidenca 65: Faqet elektronike UAMD
[499] Evidenca 132: Raporti Alumni Network
[500] Evidenca 132: Raporti Alumni Network
[501] Evidenca 88: Pyetsori i Studentit, si e drejtë e shprehjes se mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit

| dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

# VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT[502]

<table>
<tr><th colspan="5">Standardi VI.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th colspan="4">Vlerësimi</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</td><td colspan="4">Po. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka si objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme.Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës i kushton rëndësi shumë të madhe këtyre metodave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies sipas Rregullores së NJBSC të shprehur në Nenin 1, dhe Nenin 5 të kësaj Rregulloreje.<br>Neni 1 ka qëllimin dhe bazën ligjore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë përmes rregullimit dhe standartizimit të vlerësimit të proceseve në insitucion.<br>Neni 5 ka standartet kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë,e përbërë nga 10 standarte kryesore .<br>DKSC-së informacionet përkatëse, duke u konsultuar edhe paraprakisht me të, në rastet kur gjykohet e nevojshme.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</td><td colspan="4">Po. Strukturat përgjegjëse përdorin forma nga më të ndryshmet për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik, mbështetur në Nenin 1 dhe 5 të Rregullores NJSBC. Disa nga mekanizmat që përdoren për monitorimin e këtyre aftësive janë: formularët e vetëvlerësimit dhe CV e përditësuara të stafit akademik; formularët e vlerësimit të cilët plotësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe më pas nga Dekani.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</td><td colspan="4">Po. Studentët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe kjo gjë realizohet me anë të formularëve që plotësojnë çdo fund semestri si dhe me të drejtën e tyre për ankimime të shprehur në Rregullorene UAMD-së. Gjithashtu format e përmirësimit të mësidhënies janë të specifikuara në Nenin 6 të NJSBC.<br>Neni 6 Vlerësimi i cilësisë në mësimëdhënie sigurohet nëpërmjet<br>a) Pyetësorit<br>b) Vlerësimit të përgjegjësit të departamentit<br>c) Vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</td><td colspan="4">Po. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në UAMD, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik.<br>Rezultatet e përftuara i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit,si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të Stafit Akademik, të vlerësuar. Gjithnjë e më shumë UAMD po merr masa nga më të ndryshmet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</td><td colspan="4">Po. UAMD, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

502 Evidenca 73: Fusha 6, Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit

<table>
<tr><th colspan="2">Standardi VI.2<br>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</td><td>Po. UAMD-ja ka krijuar strukturat e nevojshme për sigurimin e cilësisë. Njëkohësisht, duke hartuar një politikë të qartë UAMD-ja ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron. Të gjitha reflektohen në rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, vendimet për komisionet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.<br>Bazuar në nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencorë në Republikën e Shqipërisë : "Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe proçedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë."<br>NjBSC janë si më poshtë:<br>Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në SSB.<br>Ligji për Arsimin e Lartë përcakton krijimin e një Njësie për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NjBSC) për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e kërkesave arsimore [503].</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</td><td>Po. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional NjSBC në nive Fakulteti si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë ushtrojnë kompetencat me funksione të plota në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë të Institucionit. Prioritetet strategjike të Universitetit, edhe të Fakultetit, janë të fokusuara në përmirësimin e vazhdueshëm në drejtim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku studentët janë në qendër të filozofisë së universitetit, mbështetur nga grupet e interesit. Konkretisht, mund të bazohemi në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.<br>Institucioni ka ngritur një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë I cili funcksionon në bazë të elementëve të mëposhtëm.<br>NjBSC-së kryen funksionet e mëposhtme:<br>a) Mbështet dhe ofron ekspertizë. NjBSC kryen takime pune rregullisht me çdo fakultetet dhe çdo departament dhe ftohet nga ana e tyre që të ofrojë ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, si dhe në asistimin e NjBSC ne rang fakulteti. Ekspertiza duhet të përqendrohet rreth aplikimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë për të vlerësuar në mënyrë eksplicite procesin e mësimdhënies, të nxënit, si dhe metodave moderne të vlerësimit të studentëve me qëllim promovimin e një qasjeje interaktive me në qendër studentin.<br>b) Bashkërendon. NjBSC në nivel institucional, kur procesi i delegohet NjBSC-së pranë fakulteteve, kryen një rol bashkërendues dhe mund të shtrihet edhe në njësi të tjera në universitet kur NjBSC-ja konsiderohet e lidhur me funksione të tjera si zhvillimi i personelit dhe mbledhja/analiza e të dhënave institucionale.<br>c) Interpreton detyrimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë. Ajo është përgjegjëse dhe ka për detyrë të interpretojë detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë dhe t'i përshtasë ato në kontekstin institucional të UAMD-së. NjBSC-ja garanton që këto detyrime të njihen dhe përfshihen nga IAL.</td></tr>
</table>

[503] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD/neni 8

| | |
|---|---|
| | d) Monitoron. NjBSC-së ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton probleme. Zgjidhjet e propozuara nga NJBSC-ja mbi problematikat e evidentuara, në varësi të nivelit të problemit, përmes Rektorit, mund t'i kalojnë për shqyrtim dhe miratim Senatit Akademik ose KPGSC-së.<br>e) Administron dokumentacione. NjBSC-ja administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. Ajo përpunon pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele.<br>f) Lehtëson: NjBSC-ja duhet të lehtësojë krijimin e një mjedisi të favorshëm me studentin në qendër, për arsimim cilësor dhe zhvillimin e stafit akademik për të përvetësuar njohuritë dhe teknologjitë e nevojshme për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies.<br>g) Siguron informacion për cilësinë tek aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit. NjBSC-ja siguron shpërndarjen e informacionit lidhur me treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në zbatim të legjislacionit Shqiptar.<br>1. Gjithashtu, në funksion të realizimit të funksionit të saj institucional NjBSC-ja duhet:<br>a) Të hartojë dhe zbatojë një manual procedurash që përshkruajnë strukturën e institucionit dhe proceset për sigurimin e cilësisë;<br>b) Të specifikoje kriteret për përzgjedhjen dhe formatet e treguesve, të standardeve dhe të objektivave;<br>c) Të përgatisë formularët standardë për çështje të tilla si pyetesorët per studentët, administratën dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni;<br>d) Të këshillojë mbi procedurat operative për planifikimin dhe zbatimin e proceseve të cilësisë;<br>e) Të mbledhë dhe të ruajë sistematikisht raportet mbi ecurinë, përfshirë të dhënat mbi treguesit dhe objektivat që do të kërkohen për analizën dhe raportimin e cilësisë së standardeve dhe kurrikulave[504]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | **Po.** UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.<br>Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në pjesën gjashtë të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.<br>UAMD ju nënshtrua në vitin 2016 procesit të Akreditimit Institucional dhe u vlerësua me një Akreditim për 4 vite akademike, gjithashtu u vlerësua me 4 vite akademike në riakreditimin institucional i cili u realizua në vitin 2021[505] [506].<br>*Vendimi i Bordit të Akreditimit 2016 dhe Certifikata e Akreditimit.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | **Po.** Në fund të çdo semestri javën e 13 dhe javën e 14 Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë organizon anketimin nga studentët mbi stafin akademik.<br>Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson,periodikisht,rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. NjSBC realizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Sigurimi i brëndshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit. Sistemi i brëndshëm i sigurimit të cilësisë mbështetet në garantimin e transparencës, në vlerësimin dhe rritjen e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit në promovimin e kulturës së |

[504] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD/neni 9
[505] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD/nenet 17-19
[506] Evidenca 133: Vendimi i Bordit të Akreditimit 2016 dhe Certifikata e Akreditimit.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | rritjes së vazhdueshme, në respektimin e legjislacionit për arsimin e lartë dhe për kërkimin shkencor.<br><br>Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD dhe strukturat e saj si NjBSC; Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatorët e programeve përgatisin raporte periodike (3-mujorë, 6-mujorë dhe vjetorë) të vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim. Gjithashtu DKSC realizon Raportin e vetëvlerësimit për çdo vit akademik.<br><br>NjBSC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësive të tjera të institucionit, sipas sistemit dhe mekanizmit të krijuar, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kritereve dhe standardeve të paracaktuara në Kodin e Cilësisë dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore[507]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br><br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | **Po.** Në Fakultetin e Biznesit, përdorin metoda të ndryshme si, kontrollet nga drejtuesit e Njësive Kryesore, dhe drejtuesit e Njësive Bazë analizat dhe diskutimet në mbledhje të departamentit dhe fakultetit, anketimet e studentëve dhe aktorëve të tjerë, matjet e performancës së pedagogëve me anën e disa kritereve të standartizuara më parë; këto janë në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.Në mënyrë të herëpashershme institucioni përdor mekanizma përmes të cilave mbikqyr programet e studimit. Me një sistem të sigurimit të cilësisë (dhe modelet e cilësisë në përgjithësi), UAMD përcakton marrëveshjet e saj, direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe përcakton gjithashtu proceset e saj kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Përveç monitorimit të rregullt (çdo vit dhe pjesërisht edhe çdo semestër) dhe përmirësimit, baza kryesore e këtyre aktiviteteve janë vetëvlerësimet që mund të zhvillohen së paku çdo gjashtë vjet në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL. Në rastin e akreditimit të programeve të studimit raportet e vetëvlerësimit hartohen nga GVB-ja në nivel programi, ndërsa në rastin e akreditimit institucional nga GVB e ngritur në nivel institucioni. Lektorët në mënyrë të herëpashershme dorëzojnë te koordinatorët e kërkimit shkencor formularët e raporteve të veprimtarisë së tyre kërkimore shkencore. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e proçese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregullores së NJSBC.<br><br>Programet e studimit në Fakultetin e Biznesit i janë nënshtuar riorganizimit në vitin akademik 2021-2022, kjo për arsye të pajisë studentët me njohuri e shprehi te avancuara dhe me kompetenca të gjëra që kërkohen për t'u punësuar në përputhje me nevojat e tregut të diversifikuar të punës, synon që të ofrojë një program studimi bazuar në kurrikul më bashkohore.<br><br>Nga DKSC realizohet kontrolli i kurrikulave të propozuara, sipas akteve |

[507] Evidenca 27: Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë/UAMD/neni 9

| | |
|---|---|
| | ligjore në fuqi mbi riorganizimin mbi 20% nën 20% si dhe për hapjet e programeve të reja. |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | **Po.** Raportet analitike dhe vlerësuese përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive për përmirësime të mëtejshme të cilësisë. DKSC realizon për çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Raporti hartohet duke u bazuar në 5 fushate evlerësimit:<br>**1.** Organizimi dhe Menaxhimi<br>**2.** Burimet<br>**3.** Kurrikula<br>**4.** Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi<br>**5.** Studentët dhe Mbështetja e tyre<br>Ky raport përmbledh evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | **Po.** Në kuadër të pëmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Biznesit Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. DKSC përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. DKSC-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të institucionit për të dhënat statistikore që do të parashikonte një analizë sistemike të këtyre treguesve. Strukturat e ndryshme të SBSC-së kryejnë mbledhjen e të dhënave, në varësi të llojit të informacionit të kërkuar dhe analiza përcillet në NjBSC.Gjithashtu lektorët dorëzojnë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme CV-të dhe dosjet e tyre te vetëvleresimit të cilat i disponojnë të gjithë shefat e departamenteve dhe tek burimet njërëzore. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve vlerësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga drejtuesi i njësisë kryesore. Në bazë të formularëve të raporteveçdo lektor vlerësohet me pikë për çdo fushë të kërkimit të tij shkencor gjatë një viti akademik, vlerësimi bëhet në bazë të formatit të vlerësimit i cili kalkulohet nga koordinatori i kërkimit shkencor i cili është përzgjedhur me vendim departamenti. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | **Po.** Rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë ka përfshirja e studentëve në këtë proçes dhe i grupeve të tjera të interesit. Instrumentat e përdorura për metodën tërthortë (sondazhe, intervista) janë pasqyruar në nenet 6 dhe 15 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NjSBC në çdo rast dokumenton dhe u bën të njohura Senati Akademik informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. Një prej instrumenteve për analizën e arritjeve të misionit institucional është përcaktimi i një grupi treguesish kyç të performancës (TKP). Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD-ja dhe strukturat esaj si NjSBC. Lista e TKP-së realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjSBC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik nga KPSC-ja. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** | | | |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | **Po.** UAMD ka parashikuar dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit.UAMD i jep prioritet angazhimit të studentëve nëcdo nivel të vendimarrjes. Përfaqësues të studentëve gjejmë në çdo organ kolegjal duke filluar nga Senati Akademik e deri tek GVB që ka hartuar këtë Raport të Vlerësimit të Brendshëm. Përfaqësimi i studentëve realizohet edhe në Bordin e Administrimit, NjBSC të fakultetit dhe në formë këshillimore, përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit kur trajtohen çështje të lidhura me ta. | | | |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | **Po.** Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara në nenet të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe në Rregulloren e Fakultetin e Biznesit UAMD përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm. | | | |
